3.3. Materiali mbjellës:

Fidanët që do të përdoren për mbjellje do të jenë fidanë 2-3 vjeçarë, pa bukë dheu, të llojit Lis dhe Arrë të çertifikuar (me çertifikatë origjine dhe cilësie), brenda standarteve shtetërore. Fidanat duhet të kenë sistem rrënjor të zhvilluar mirë, të pa dëmtuar, pa pjesë të thara. Trupi të jetë i drunjëzuar, i

pa dëmtuar, i drejtë, i pa bigëzuar, me sytha të zhvilluar normalisht dhe të pa çelur. Fidani të jetë i pa prekur nga sëmundje apo dëmtues, gjithashtu të jetë i freskët dhe jo i mpirë nga ngricat apo mungesa e lagështirës.

Mundësisht fidanët duhet të jenë të prodhuar nga ndonjë fidanishte e zonës, sa më afër objektit të pyllëzimit ose në ndonjë vend tjetër që ka kushte atmosferike dhe gjeografike të njëjta ose të përafërta me objektin ku do të kryhet pyllëzimi. Transportimi i fidanëve bëhet me çdo lloj mjeti, por gjithmonë me rrënjët e mbuluara pamvaresisht nga largësia. Kjo do të rritë sigurinë e mos dështimit të objektit për shkak të cilësisë së fidanëve.

Përmasat e fidanëve që do përdoren për pyllëzim janë si më poshtë:

nr	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe		
		Trashësia e qafës (mm)	Gjatësia e fidanit (cm)	Gjatësia e rrënjës (cm)
A	Fletorë	≥ 10 - 15	≥ 100 - 120	≥ 25 - 30
1	Lis (Quercus sp.)	≥ 10	≥ 100	≥ 25 - 30
2	Arrë (Juglans regia)	≥ 15	≥ 120	≥ 30

Nevojat për fidanë për 1ha:

nr	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe			
		Njësia matjes	Gjithsej	Pyllëzime	Zevendësime
A	Fletorë	copë	2100	1777	353
1	Lis (Quercus sp.)	copë	2000	1667	333
2	Arrë:Arrë (Juglans regia)	copë	100	100	20

3.4. Mënyra e përgatitjes së tokës:

Gjatë zbatimit të këtij projekti, do të kryhen punime pyllëzimi duke respektuar të gjithë parametrat teknik të proceseve të punimeve të planifikuara, që nga piketimi, hapja e gropave, ruatja e skemës

së pyllëzimit, shtratifikimi dhe nxjerrja e fidanëve, mbjellja e tyre si dhe shërbimet kulturale për tre vite. Të gjitha këto parametra që përmendëm duhet të respektohen në mënyrë të tillë që të kemi një ecuri të mirë në zenien e fidanëve dhe në krijimin e grumbullit të ri, i cili do të ketë një ndikim pozitiv si në aspektin social ekonomik ashtu edhe në atë mjedisor.

- Përpara mbjelljes, do të bëhet piketimi i gropave. Për druret pyjor (Lisi), gropat do të hapen 40x40cm. Largësia midis gropave do të jetë 3x2 m. ku në një ha do të hapen 1667 gropa. Për Arren gropat do të kenë përmasa 60 x 60 x 60 cm. Largësia midis gropave do të jetë 10 x 10 m. ku në një ha do të hapen 100 gropa.

Gjatë hapjes së gropave, dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njëri-tjetri (në shtresa). Gjatë hapjes së gropave, gjysma e dheut (i shtresës së sipërme) të hidhet në krahun e majtë të gropës, ndërsa gjysma tjetër (i shtresës së poshtme) në krahun e djathtë. E kundërta do të ndodhë gjatë procesit të mbushjes e mbjelljes së fidanit. Mbjellja e fidanave të bëhet në periudhën e pushimit të vegetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor i tyre nga ngricat.

Transporti i fidanëve brenda parcelës do të bëhet me krahë. Gjatë transportit dhe shpërndarjes së fidanëve në objekt duhet të tregohet kujdes në mënyrë që ata të mos dëmtohen mekanikisht. Mbjellja do të bëhet nga dy punëtorë të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtij procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i shtresës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Para mbjelljes duhet të kontrollohet sistemi rrënjor i fidanit. Në rast se ka rrënjë të përdredhura, ato shkurtohen me kujdes me gërshërë të posaçme.

Fidani vendoset në qendër të gropës, në mënyrë që të ruhet skema e mbjelljes. Qafa e rrënjës së fidanit të jetë 2-3 cm në nivelin e pjesës së sipërme të gropës. Gropa mbushet me dhe anash fidanit duke e ngjeshur herë pas here me kujdes, në mënyrë që të sigurohet kontakti i rrënjëve me dheun e hedhur në gropë. Gjatë mbushjes së gropës me dhe bwhet ngjeshja, të tregohet kujdes në mënyrë që fidani të ruhet i padëmtuar. Pas mbjelljes së fidanit, dheu do të ngjeshet me kujdes, në mënyrë që të eliminohen fluskat e ajrit të tokës të cilat influencojnë negativisht në drejtim të zënies së tij. Në zona të thata, sipërfaqes së gropës i jepet formë konkave, ndërsa në ato pjesë ku toka mund të mbajë lagështi, formë konvekse. Gurët që rezultojnë gjatë mbushjes së gropës, vendosen në pjesën e poshtme të saj në formë muri, në mënyrë që të mbrojnë terrenin nga erozioni.

Afatet e kryerjes së punimeve, lloji dhe cilësia e fidanëve si dhe teknika e zbatimit të punimeve gjatë mbjelljes, do të zbatohen dhe gjatë procesit të zëvendësimeve, i cili do të kryhet vitin e dytë pas mbjelljes.

3.5. Koha e kryerjes së punimeve:

Punimet përgatitore (Piketimi dhe hapja e gropave) do të kryhen gjatë muajve Nëntor-Dhjetor, ndërsa procesi i mbjelljes do të bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit (Nëntor-15 Mars).

Rekomandohet që mbjellja e fidanëve të bëhet brenda një kohe sa më të shkurtër nga hapja e gropave, për të monitoruar në mënyrë korrekte kryerjen e punimeve.

Sigurimi i materialit mbjellës (fidanëve) duhet të bëhet para se të fillojë hapja e gropave, rekomandohet nga muaji Tetor për arsyen që kur të hapen gropat të mos kemi vonesa. Shkulja e fidanëve nga fidanishtja, transporti, shtratifikimi në objekt dhe mbjellja e tyre duhet të bëhet vetëm në periudhën e pushimit të vegjetacionit.

3.6. Parashikimi i përqindjes së zënieve për periudhën Qershor-Shtator:

Përqindja e zënieve parashikohet në pranverë 90% dhe në vjeshtë 80 %. Në funksion të përqindjes së zënieve të vjeshtës, përcaktohet numri i fidanëve që do zëvendësohen. Zëvendësimi i fidanëve të tharë, do të bëhet sezonin pasardhës të mbjelljeve. Sasia e fidanëve që do të zëvendësohen është e njëjtë me numrin e atyre që janë tharë.

Objekti parashikohet që të mirëmbahet për 3 vite. Në fund të vitit të tretë, në mënyrë që pyllëzimi të jetë i suksesshëm, përqindja e zënieve parashikohet të jetë $\geq 80\%$.

3.7. Shërbimet kulture dhe ruajtja:

Pas përfundimit të pyllëzimeve në vitin pasardhës do të kryhen zëvendësime në masën 20% për fidanët e dështuar në vitin e parë si dhe pas monitorimit dhe verifikimit të zënieve (të vjeshtës) në muajin shtator.

Prashitja e fidanëve si dhe heqja e barërave të këqia do të bëhet në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të mbjelljes. Prashitjet do të shoqërohen me plehërim kimik (Dap ose Nitrat), duke përdorur rreth 50 kg/ha për çdo prashitje. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 20-25 gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm për sasinë e fidanëve që mund të prashiten brenda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbuluar, i humbet elementët ushqyes për bimën.

Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune (Shatë), duke u përshtatur me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 0.3 m nga fidani e thellësi 10 – 15 cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkruftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore

Koha e kryerjes së prashitjeve do të jetë periudha Qershor - Korrik. Rekomandohet që prashitjet të bëhen 2-3 ditë pas rënies së shirave ose uitjes, në mënyrë që të ruhet sa më shumë lagështira në gropë. Objekti duhet të mbrohet nga kullotja për 3 vjet dhe në rast të shfaqjeve të dëmtuesve apo sëmundjeve duhet të bëhet luftimi i tyre. Të gjitha këto punime, do të jenë pjesë e investimit të këtij objekti, duke ndikuar në sigurimin e përqindjes së zënies së planifikuar dhe zhvillimin e mëtejshëm të grumbullit pyjor. Subjekti i kontraktuar në bashkëpunim me Strukturat Menaxhuese të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Bashkisë Himarë, komunitetin e zonës, të marrin masat e nevojshme administrative për mbrojtjen e objektit nga kundravajtjet, zjarret dhe kullotje për një periudhë 3 vjeçare.

3.8. Grafiku i kryerjes së punimeve:

	ID: G80212207K, stafi teknik i Bashkisë Himarë. D.1.10. Kontrolli, marrja në dorëzim e punimeve të realizuara për zëvendësimet dhe shërbimet kulturore dhe hartimi i dokumentacionit përkatës, nga drejtuesi teknik i subjektit "Bardhosh Lesko Celoleskaj" ID: G80212207K, specialistët e Bashkisë Himarë.	Viti i I-rë, II-të dhe III-të pas pyllëzimit
Rezultatet e pritshme	Shtimi i fondit pyjor me pyje të lartë, plotësimin e nevojave të komunitetit për prodhime të dyta pyjore (fruta), lëndë drusore, përmirësimi i peizazhit, krijimi i kushteve më të favorshme për zhvillimin e faunës si dhe minimizimi i fenomenit të erozionit.	

KAPITULLI I II

STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM.

2.1. Vendosja gjeografike dhe administrative:

Objekti ndodhet në Njesinë Administrative Hore-Vranisht, në veri-Lindje të Bashkisë Himarë, ngastra 69, Ekonomia Pyjore Mali i Pilurit-Cike.

Vendndodhja e Objektivit të Pyllëzimit të Agropylltarisë

Kordinatat e objektit në UTM:


Nr.	Kordinata E	Kordinata N
1	390817	4453037
2	390873	4452971
3	390776	4452999
4	390724	4452988
5	390668	4453023
6	390664	4452955



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARE

PROJEKT TEKNIK AGROPYLLTARIE

*((Për rehabilitimin e tokave me bimësi pyjore, hapësira
boshe dhe në depozitime dhe' i pastër))*



2023

Bashkia Himarë

PROJEKT TEKNIK -AGROPYLLTARI


(Për' rehabilitimin e tokave me bimësi pyjore, hapësira boshe dhe në depozitime dhe' i pastër)

Njesia Administrative: Hore-Vranisht

Bashkia: Himarë

Ngastra Pyjore: 69

Ekonomia Pyjore: Mali i Pilurit-Cike



PROJEKTOI

Ing. Avni Abedini

Licence nr. 136, date 18.09.2009

Porosites:

Subjekti: Bardhosh Lesko Celoleskaj

ID: G80212207K

VITI 2023

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

1. KAPITULLI I-rë; KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Konsiderata të përgjithshme.
- 1.2. Qëllimi i projektit.
- 1.3. Detyra e projektit.
- 1.4. Vizioni i projektit.
- 1.5. Konteksti i projektit dhe objektivat.
- 1.6. Përshkrimi i objektiveve të projektit.
- 1.7. Plani i punës.

2. KAPITULLI II-të; STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM

- 2.1. Vendosja Gjeografike dhe Administrative
- 2.2. Kufinj të natyral.
- 2.3. Sipërfaqja e Objektivit.
- 2.4. Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara.
- 2.5. Gjeomorfologjia, forma e terrenit dhe gjeologjia.
- 2.6. Kundrejtimi i objektivit.
- 2.7. Lartësia mbi nivelin e detit.
- 2.8. Hidrologjia.
- 2.9. Kushtet klimatike.
- 2.10. Kushtet Pedologjike.
- 2.11. Bimësia Egzistuese.

3. KAPITULLI III-të; TEKNIKAT E KRYERJES SË PUNIMEVE

- 3.1. Zgjedhja e llojeve.
- 3.2. Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit.
- 3.3. Materiali Mbjellës.
- 3.4. Mënyra e përgatitjes së tokës.
- 3.5. Koha e kryerjes së punimeve
- 3.6. Parashikimi ipërqindjes së zënieve
- 3.7. Shërbimet Kulturale dhe ruajtja
- 3.8. Grafiku i kryerjes së punimeve

4. KAPITULLI IV-të; VLERËSIMI I PROJEKTIT

- 4.1. Analiza e riskut.
- 4.2. Qëndrueshmëria e projektit.
- 4.3. Ndikimi social ekonomik.
- 4.4. Buxheti i planifikuar.
- 4.5. Kohëzgjatja e projektit.
- 4.6. Vlerësimi dhe monitorimi.

5. KAPITULLI V-të; ANEKSE

- 5.1. Harta e objektivit.
- 5.2. Foto satelitore e pozicionimit të objektivit.
- 5.3. Planimetria e objektivit.
- 5.4. Preventivat.
- 5.5. Përshkrimi i llojit.

KAPITULLI I

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

1. Të hartohet Projekt Agropylltarie me Lloje pyjor: Lis (Quercus sp.) etj, dhe arrore: "Arrë (Juglandis regia.)etj,në ngastren pyjre 69, ne Ekonomine Pyjore Mali i Pilurit-Cike.

1.1. Konsiderata të përgjithshme :

Në Objektin me sipërfaqe totale prej rreth 1.74 ha, propozohet të pyllëzohet në Agropylltari me drure pyjor e frutore(arrowë):*hapesirat boshe dhe ato sipërfaqe qe do te rezultojne per rehabilitim nga aktivitetet qe do te kryej subjekti me destinacion turizmin-kampingje, dhe te tjera me qellim zhvillimin e agroturizmit. Objekti ndodhet në ngastrat pyjore 69, ne Ekonomine Pyjore Gjomollas, është në pronësi të Bashkisë " Himarë "dhe shtrihet në territorin e kësaj Bashkie Në këtë ngastër ka filluar të shtohet erozioni. Objekti në fjalë shtrihet në zonën fitoklimatike Lauretum dhe te dushqeve (Quercus).Shtrihen në Bashkinë" Himarë" .*

Ajo aktualisht qeveriset si sipërfaqe fond pyjore me regjimin ,shkurre si dhe toke me bimesi pyjore dhe barishtore dhe inproduktive. Aktualisht, sipërfaqja e objektit është e veshur me bimë të llojit mare,prral,mbrete etj. Bimësia barashtirore në këtë parcelë është e varfër e përbërë kryesisht nga bimë të familjes graminace (xhufka, grami, etj), legumizet (tërfili i egër, zhuke etj). të cilat janë përshtatur mjaft mirë me formacionin tokësor.

Si rezultati keqqeverisjes dhe veprimtarisë së faktorëve atmosferikë,pershkrimi nga zjarri ne vite, objekti ka hapësira boshe dhe te degraduara. Erozioni ka filluar të shfaqet në sipërfaqe si dhe do te shtohet me nderhyrjet per aktivitetin e zhvillimit te agroturizmit e kerkuar.

Nga vrojtimi në terren, rezultoi se kjo sipërfaqe pyjore është e përshtatshme për t'u rehabilituar nëpërmjet pyllëzimit me fidanë të llojit Lis (Quercus sp.,psh. Shparth, ilqe) dhe Arre (Juglans regia. Qëllimi kryesor i kësaj ndërhyrjeje është të krijojë një masiv me pyje, i cili do të ndikojë në stabilizimin e terrenit dhe mbrojtjen nga fenomeni i erozionit dhe nderhyrjeve meaktivitete te agroturizmit, përmirësimin e strukturës së tokës.Gjithashtu do të ketë ndikim pozitiv edhe në rregullimin e parametrave të ekosistemit, si në aspektin floristik dhe faunistik, ashtu dhe në këndvështrime të tjera, që do të thotë më shumë masë të gjelbërt, më shumë dioksid karboni i fiksuar si dhe një peizash me të mirë për zonën.

1.2. Qëllimi i projektit :

Qëllimi kryesor i pyllëzimit është të realizojmë instalimin e një shoqërimi bimor pyjor në një mjedis apo zonë të caktuar në të cilën instalimi i filizërisë në mënyrë natyrore është i pamundur.

Ndërhyrja me punime për pyllëzimin , e cila aktualisht është pothuajse e zhveshur nga vegetacioni pyjor, si dhe në sipërfaqet që do të preket mbulesa bimore nga aktivitetet e mevonshme, do të synojë në stabilizimin dhe mbrojtjen e objektit nga fenomeni i erozionit dhe gërryrjeve të tokës. Krijimi i një plantacioni me pyje të llojit Lis dhe Arre në objektin e propozuar, i cili krahas funksionit mbrojtës të tokës, do të ndikojë dhe në plotësimin e nevojave të komunitetit për lëndë drusore në të ardhmen, në menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, në përmirësimin e peizazhit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në afërsi të tij.

1.3. Detyra e projektit :

Të sigurohet ripërtëritja artificiale nëpërmjet pyllëzimit me fidanë të llojit pyjor: Lis (*Quercus sp.*) dhe Arre (*Juglans regia*) në hapësirat boshe dhe hapësirat rehabilituese të objektit ku do të realizohet pyllëzimi. Detyra kryesore e këtij projekti, është që në përputhje me kushtet stacionare të objektit, të realizohen punimet e nevojshme për mbjelljen dhe për sigurimin e kushteve sa më optimale deri në instalimin e grumbullit të ri pyjor.

1.4. Vizioni i projektit:

Duke e vlerësuar në vend këtë sipërfaqe, e cila aktualisht është sipërfaqe me bimësi pyjore, krijohet mundësia e shtimit të habitateve dhe rritjes së interesit të komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor. Duke vlerësuar të gjithë faktorët e tjerë ekologjik si biodiversitetin, klimën, tokën, erozionin, ndotjen, peizazhin, etj, e themi me plot bindjen se realizimi i këtij pyllëzimi do të ndikojë pozitivisht në të gjithë faktorët e sipërpërmendur.

1.5. Konteksti i projektit dhe objektivat:

Ky projekt ka konceptin e ndërhyrjes me pyllëzime artificiale në Agropylltari, për të bërë të mundur shtimin e habitateve pyjore, krijimin dhe përmirësimin e peizazhit malor si dhe shtimin e masës së gjelbërt dhe asaj drunore. Realizimi i ndërhyrjes për instalimin e grumbullit pyjor, do të ndikojë në përmirësimin e peizazhit natyror, cilësinë e ajrit si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin dhe shtimin e faunës dhe florës.

Kryerjave punimeve të pyllëzimit në Agropylltarinë këtë parcelë, do të ndikojë drejtpërsëdrejti së pari, në mbrojtjen e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet sistemit rrënjor të bimës, së dyti do të ketë edhe një efekt shumë të rëndësishëm ekologjik, pasi lloji që është planifikuar për të mbjellërrregullon strukturën e tokës, frenon erozionin e mëtejshëm si dhe krijon mundësi të reja për zhvillimin dhe grumbullimin e bimëve mjekësore. Gjithashtu do të reduktojë ndotjen duke rritur masën e fiksimit të dioksidit të karbonit në jethe dhe përmirësimin e peizazhit natyror. Efekti i këtij pyllëzimi në Agropylltari është edhe në shtimin e habitateve në terrene të degraduara, që rehabilitohen, pasi frutat e arres janë me vlera ushqyese për njerëzimin dhe kerkohen në

treg.Gjithashtu, druri i arres është një dru me leverdishmëri ekonomike dhe i kërkuar nga industria e drurit.

1.6.Përshkrimi i objektivave të projektit:

Zbatimi i këtij projekti ka si objektiv shtimin dhe dendesimin e grumbullit pyjore, në një sipërfaqe pyjore e qeverisur si trungishte, e cilado të arrihet duke e pyllëzuar me fidanë të llojit: "Lis (Quercus sp.) dhe arrore, Arre (Juglans regia) .

Për këtë do të synohen këto objektiva:

1. Rritja e sipërfaqeve me habitate të ndryshme në nivel bashkie, duke kryer pyllëzime artificiale në Agropylltari me lloje të tilla që përshtaten kushteve stacionale të vendit.
2. Do të rriten vlerat e biodiversitetit, pasi në kushtet aktuale nuk mund të flitet për të. Me krijimin e kësaj Agropylltarie, në të ardhmen, pas një periudhe 15-20 vjeçare do të kemi një përmirësim si në rritje të volumit të lëndës drusore, prodhimtarisë të frutave, masës së gjelbërt, përmirësim dhe pasurim të tokës me humus, do të kemi një imazh tjetër floristik dhe faunistik, do të kemi më të zhvilluar faunën e gjërë, si dhe rritjen e prodhimtarisë së bimëve medicinale.
3. Me krijimin e këtij grumbulli të ri, do të përmirësohet bilanci i plotësimit të nevojave të komunitetit për prodhim frutash, lëndë drusore nga krasitjet, biomasa e prodhime të tjera si bimë mjeksore, kullotje dhe sigurim i të ardhurave financiare nga tregu realizuar, organizuar dhe i monitoruar i këtyre produkteve, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-financiare të komunitetit si dhe duke siguruar të ardhura në funksion të Bashkisë Himarë.
4. Rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, si dhe përmirësimin e peizazhit natyror.
5. Përmirësimi i shërbimeve mjedisore si: ulja e sasisë së CO₂, ulja e fenomeneve të gërryerjes, erozionit, mbrojtja e biodiversitetit, etj.
6. Sigurimi i mundësive të punësimit, shlodhjes dhe rekreacionit të popullsisë lokale.

1.7. Plani i punës:

PP1	Manaxhimi i Projektit " Agropylltari "	Afati
Objektivi	Pyllëzim Agropylltarie me llojin "Lis (Quercus sp.) dhe Arre (Juglans regia) " i sipërfaqes së zhveshur, hapësirave boshe, hapësirave që preken me demtim të mbuleses bimore nga aktivitetet e destinacione të tjera të subjektit, për shtimin e fondit pyjor, minimizimin e gërryerjeve, rehabilitimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor e bujqësor nga erozioni.	12 muaj
Lider i PP	Lider i PP është Subjekti: Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K	36 muaj
Detyrat	<p>D.1.1. Zgjedhja e llojit, propozohet që pyllëzimi të bëhet me llojin Lis (Quercus sp.) dhe Arre (Juglans regia).</p> <p>D.1.2 Sigurimi i fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve nga banorët e zonës, do bëhet nga stafi i subjektit Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K.</p> <p>D.1.3. Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve do bëhet nga drejtuesi teknik i subjektit Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K, specialistët e Bashkisë Himarë.</p> <p>D.1.4. Piketimi sipas skemës së mbjelljes.</p> <p>D.1.5. Hapja e gropave dhe kontrolli i tyre nga drejtuesi teknik i subjektit Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K , specialistët e Bashkisë Himarë.</p> <p>D.1.6. Sigurimi, transporti dhe shtratifikimi i fidanëve 1-2 vjeçar, sipas parametrave cilësorë dhe të çertifikuar.</p> <p>D.1.7. Mbjellja e fidanëve, duke respektuar teknikën e zbatimit të planifikuar në projekt e në preventivat e punimeve.</p> <p>D.1.8 Kontrolli periodik i realizimit të punimeve të kryera nga drejtuesi teknik i subjektit "Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K, specialistët e Bashkisë Himarë.</p> <p>.1.9. Kontroll, marrja në dorëzim e punimeve të realizuara dhe hartimi i dokumentacionit përkatës, nga drejtuesi teknik i subjektit "Bardhosh Lesko Celoleskaj</p>	<p>1 muaj nga lidhje e kontratës.</p> <p>Para fillimit të punimeve</p> <p>Para fillimit të punimeve</p> <p>Tetor- Nëntor</p> <p>Nëntor-Dhjetor</p> <p>Dhjetor - Shkurt</p> <p>Dhjetor - Shkurt</p> <p>Gjat gjith periudhës së zbatimit të punimeve.</p> <p>Mars - Prill</p>

	ID: G80212207K, stafi teknik i Bashkisë Himarë. D.1.10.Kontrolli, marrja në dorëzim e punimeve të realizuara për zëvendësimet dhe shërbimet kulturore dhe hartimi i dokumentacionit përkatës, nga drejtuesi teknik i subjektit "Bardhosh Lesko Celoleskaj ID: G80212207K, specialistët e Bashkisë Himarë.	Viti i I-rë, II-të dhe III-të pas pyllëzimit
Rezultatet e pritshme	Shtimi i fondit pyjor me pyje të lartë, plotësimin e nevojave të komunitetit për prodhime të dyta pyjore (fruta), lëndë drusore, përmirësimi i peizazhit, krijimi i kushteve më të favorshme për zhvillimin e faunës si dhe minimizimi i fenomenit të erozionit.	

KAPITULLI II

STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM.

2.1.Vendosja gjeografike dhe administrative:

Objekti ndodhet në Njesinë Administrative Hore-Vranisht, në veri-Lindje të Bashkisë Himarë, ngastra 69,Ekonomia Pyjore Mali i Pilurit-Cike.

Vendndodhja e Objektivit të Pyllëzimit të Agropylltarisë

Kordinatat e objektit ne UTM:

Nr.	Kordinata E	Kordinata N
1	390817	4453037
2	390873	4452971
3	390776	4452999
4	390724	4452988
5	390668	4453023
6	390664	4452955

7	390584	4452958
---	--------	---------

2.2.Kufinjte Natyralë:

Objekti i planifikuar për realizimin e punimeve të pyllëzimit kufizohet nga:

Nga veriu: Rruga e re Kuc-Qeparo

Nga jugu: Pyll.

Nga lindja: Pyll.

Nga perëndimi:Pyll

• 2.3.Sipërfaqja:

Sipërfaqjaqë kerkohet me qera është rreth 11 ha, sipërfaqja që do të përshkohet me punime pyllëzimi në Agropylltari janë :hapesirat boshe dhe nga sipërfaqet që shtresa e bimesise do të demtohet me aktivitetet që do të kryej subjekti me destinacion zhvillimin e agroturizmit. Objekti ndodhet në anë të rrugës auto .

2.4.Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:

Objekti ,i propozuar për t'u pyllëzuar në Agropylltari, përshkohet nga rrugë automobilistike. Distanca nga deti Jon është rreth 12km. Ndodhet në anë të rrugës auto Kuc-Qeparo.

2.5.Gjeomorfologjia, forma e terrenit,gjeologjia:

Objekti qëdo të pyllëzohet në Agropylltari është kulem kodre.

Nga ana gjeologjike objekti ndodhet i vendosur mbi formacione shkembore, të shkrufta dhe të ajrosura.

2.6.Kundrejtimi:

Objekti ku do të kryhet pyllëzimi ka kundrejtim Jug – Perëndim, me terren kulem kodre

2.7.Lartësia mbi nivelin e detit:

Lartësia e ngastrës mbi nivelin e detit,mesatare 549 m mbi nivelin e detit.

2.8.Hidrologjia:

Objekti ku do të kryhet pyllëzimi,përshkohet nga disa rrëqe e përroska të thata gjatë verës, të cilat mbajnë ujë vetëm gjatë periudhave me reshje.

2.9.Kushtet Klimatike:

Përshkrim i përgjithshëm

Karakteristikat	
Tipet kryesore te klimës	Mesdhetare, Me dimër të butë dhe me reshje. Vere të nxehtë dhe të thatë.
Vendndodhja e stacionit me të afërt meteorologjik	Shërbimi meteorologjik i Vlores
Reshjet mesatare vjetore (mm)	980-1000 mm shi
Muaji me reshjet me të dëndura	Muaji Nëntori dhe Janari me rreth 350 mm
Muaji me reshje dëbore	S'ka
Fillimi dhe fundi i shirave të vjeshtës	Fillimi i Tetorit deri fundi i Nëntorit
Fillimi dhe mbarimi i reshjeve ne pranvere	Mesi i Marsit deri fundi i Majit
Fillimi dhe përfundimi i reshjeve të dëborës	S'ka
Muaji i shkrirjes së plotë të dëborës	S' ka
Fillimi dhe përfundimi i periudhës së thatë	Fillimi i korrikut deri fund të Shtatorit
Data e ngricës së pare	Fundi i Dhjetorit -Janar
Data e ngricës së fundit	Fillimi i Janarit
Temperatura mesatare vjetore	Mesatare e lart 19 °C temperatura minimale -5grad.
Muajt e tokës së ngrirë (lartësi 50cm)	S' ka
Tipet kryesore të klimës	Klima Mesdhetare (nën zona qendrore) . Në zonën fitoklimatike të dafinës (Lauretum).

2.10.Kushtet pedologjike: (tipi i tokës dhe karakteristikat e saj)

Toka e objektit bënë pjesë në tipin e tokave të hinjta-kafe me struktur aluvionale

2.11. Bimësia egzistuese:

Objekti i propozuar për t'u pyllëzuar në Agropylltari, aktualisht është sipërfaqe me drure pyjor. Objekti, në mënyrë natyrale është veshur pjesërisht me Lis dhe shkurre mesdhetare të llojit trëndafil i egër, mare, shkoze etj. Gjendja vegetative në përgjithësi e degraduar nga zjarri.

KAPITULLI III

TEKNIKA TË KRYERJES SË PUNIMEVE

3.1. Zgjedhja e llojeve.

Në zgjedhjen e llojit pyjor për pyllëzim, është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kyesorë :

- a) Qëllimi i pyllëzimit;
- b) Kushtet e ekologjike, vegetacionale e dinamike të objektit;
- c) Veçoritë biologjike të llojit;

Për zgjedhjen e llojit pyjor jemi bazuar në "*Metodën e Ekologjisë së Krahasuar*" Kjo mënyrë zakonisht zbatohet për zgjedhjen e llojeve dhe prejardhjeve kur nuk kemi ngritur eksperimente dhe kur rezultatet kërkohen për një periudhë kohore të shkurtër. Ajo lejon përdorimin e prejardhjeve mbi bazën e krahasimit të kushteve të biologjisë së njohur të llojeve në vendin e tyre me mjedisin, pa marrë në konsideratë aftësinë e tyre për përshtatje në kushte të reja. Duke qënë se: "Lis (Quercus sp. dhe Arra (Juglans regia)" kanë një bonitet të mirë gjatë ciklit jetësor tërritjes së tyre si dhe përshtatet me kushtet klimatike, pedologjike dhe stacionale të zonës ku ndodhet objekti, ka sistem rrënjor të fuqishëm, i cili rregullon strukturën e tokës dhe frenon zhvillimin e mëtejshëm të erozionit, si dhe pasuron biodiversitetin, rekomandojmë që të përdoret për pyllëzim.

Përpërcaktimin e llojit që do të mbillet në objekt "Lis (Quercus sp.) dhe Arra (Juglans regia)" janë marrë në konsideratë apo janë vlerësuar kritere si më poshtë:

- Vegetacioni egzistues në afërsi të objektit;
- Historikui vegetacionit;
- Ndikimi nga ngricat e pranverës;
- Ekspozimi i specieve (ekspozimi ndaj klimës, tokës, kushteve ekstreme etj);
- Kërkesa e specieve, ndaj tokës (lëndëve ushqyese dhe elementëve të tjerë);
- Kërkesat ndaj dritës;
- Sistemi rrënjor;


Duke analizuar këto kritere, themi se lloji pyjor "Lis (Quercus sp.) dhe Arra (Juglans regia)" i përzgjedhur për t'u mbjellë në këtë objekt, i përshtatet mjaft mirë kushteve klimatiko-tokësore të këtij objekti dhe nuk rrezikohet në raste të shfaqjes së kushteve ekstreme të përkohëshme.

3.2. Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit:


Per druret pyjor:

Skema e mbjelljes për lajthinë është 3 x 2 m. Duke mbajtur parasysh konfiguracionin e terrenit si dhe nevojën e llojeve të zgjedhur për ushqim e dritëzim, kjo skemë garanton zhvillim normal të: Lisit dhe përshtatet me konfiguracionin e terrenit. Në mënyrë që grumbulli të jetë sa më natyral, përsa i përket pejzazhit, rekomandohet që të ndiqet forma e mëposhtme e skemës së pyllëzimit; Kjo realizohet duke spostuar në mënyrë të alternuar rreshtat vertikal me $\frac{1}{2}$ e distancës ndërmjet bimevenga njëra-tjetra.

Skema e Mbjelljes arror (Lloji Arrë)



bimëvenga njëra-tjetra.



Formula e pyllëzimit në Agropylltari dojetë drure pyjor te llojit Lis dhe drure Arrorë te llojit: Arrë

Metoda e pyllëzimit zgjidhet në vartësi të kushteve stacionale të objektit dhe veçorive biologjike të llojit që propozohet të mbillet. Për zgjedhjen e metodës së pyllëzimit, duhet të bëhet krahasim i avantazheve dhe

disavantazheve të secilit faktor, duke propozuar atë më të përshtatshmen. Duke patur në konsideratë faktet e mësipërme si dhe qëllimin e pyllëzimit, është propozuar metoda e pyllëzimit me fidanë.

3.3. Materiali mbjellës:

Fidanët që do të përdoren për mbjellje do të jenë fidanë 2-3 vjeçarë, pa bukë dheu, të llojit Lis dhe Arrë të çertifikuar (me çertifikatë origjine dhe cilësie), brenda standarteve shtetërore. Fidanat duhet të kenë sistem rrënjor të zhvilluar mirë, të pa dëmtuar, pa pjesë të thara. Trupi të jetë i drunjëzuar, i

3.3. Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit:

Skema e mbjelljes për Arren është 6 x 6 m. Duke mbajtur parasysh konfiguracionin e terrenit si dhe nevojën e llojeve të zgjedhur për ushqim e dritëzim, kjo skemë garanton zhvillim normal të: "Arres" dhe përshtatet me konfiguracionin e terrenit. Në mënyrë që grumbulli të jetë sa më natyral, përsa i përket pejzazhit, rekomandohet që të ndiqet forma e mëposhtme e skemës së pyllëzimit; Kjo realizohet duke spostuar në mënyrë të alternuar rreshtat vertikal me $\frac{1}{2}$ e distancës ndërmjet

pa dëmtuar, i drejtë, i pa bigëzuar, me sytha të zhvilluar normalisht dhe të pa çelur. Fidani të jetë i pa prekur nga sëmundje apo dëmtues, gjithashtu të jetë i freskët dhe jo i mpirë nga ngricat apo mungesa e lagështirës.

Mundësisht fidanët duhet të jenë të prodhuar nga ndonjë fidanishte e zonës, sa më afër objektit të pyllëzimit ose në ndonjë vend tjetër që ka kushte atmosferike dhe gjeografike të njëjta ose të përafërta me objektin ku do të kryhet pyllëzimi. Transportimi i fidanëve bëhet me çdo lloj mjeti, por gjithmonë me rrënjët e mbuluara pamvaresisht nga largësia. Kjo do të rritë sigurinë e mos dështimit të objektit për shkak të cilësisë së fidanëve.

Përmasat e fidanëve që do përdoren për pyllëzim janë si më poshtë:

nr	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe		
		Trashësia e qafës (mm)	Gjatësia e fidanit (cm)	Gjatësia e rrënjës (cm)
A	Fletorë	≥ 10 - 15	≥ 100 - 120	≥ 25 - 30
1	Lis (Quercus sp.)	≥ 10	≥ 100	≥ 25 - 30
2	Arrë (Juglans regia)	≥ 15	≥ 120	≥ 30

Nevojat për fidanë për 1ha:

nr	Lloji i fidanit	Pyllëzime në blloqe			
		Njësia matjes	Gjithsej	Pyllëzime	Zevendësime
A	Fletorë	copë	2100	1777	353
1	Lis (Quercus sp.)	copë	2000	1667	333
2	Arrë:Arrë (Juglans regia)	copë	100	100	20

3.4. Mënyra e përgatitjes së tokës:

Gjatë zbatimit të këtij projekti, do të kryhen punime pyllëzimi duke respektuar të gjithë parametrat teknik të proceseve të punimeve të planifikuara, që nga piketimi, hapja e gropave, ruatja e skemës

së pyllëzimit, shtratifikimi dhe nxjerrja e fidanëve, mbjellja e tyre si dhe shërbimet kulturale për tre vite. Të gjitha këto parametra që përmendëm duhet të respektohen në mënyrë të tillë që të kemi një ecuri të mirë në zenien e fidanëve dhe në krijimin e grumbullit të ri, i cili do të ketë një ndikim pozitiv si në aspektin social ekonomik ashtu edhe në atë mjedisor.

- Përpara mbjelljes, do të bëhet piketimi i gropave. Për druret pyjor (Lisi), gropat do të hapen 40x40cm. Largësia midis gropave do të jetë 3x2 m. ku në një ha do të hapen 1667 gropa. Për Arren, gropat do të kenë përmasa 60 x 60 x 60 cm. Largësia midis gropave do të jetë 10 x 10 m. ku në një ha do të hapen 100 gropa.

Gjatë hapjes së gropave, dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njëri-tjetri (në shtresa). Gjatë hapjes së gropave, gjysma e dheut (i shtresës së sipërme) të hidhet në krahun e majtë të gropës, ndërsa gjysma tjetër (i shtresës së poshtme) në krahun e djathtë. E kundërta do të ndodhë gjatë procesit të mbushjes e mbjelljes së fidanit. Mbjellja e fidanëve të bëhet në periudhën e pushimit të vegetacionit, në ditë pa ngrica, në mënyrë që të mos dëmtohet sistemi rrënjor i tyre nga ngricat.

Transporti i fidanëve brenda parcelës do të bëhet me krahë. Gjatë transportit dhe shpërndarjes së fidanëve në objekt duhet të tregohet kujdes në mënyrë që ata të mos dëmtohen mekanikisht. Mbjellja do të bëhet nga dy punëtorë të specializuar dhe instruktuar paraprakisht nga specialistët përkatës për mënyrën e kryerjes së këtij procesi. Në fillim do të hidhet në gropë dheu i shtresës së sipërme të ndarë gjatë hapjes së gropës. Para mbjelljes duhet të kontrollohet sistemi rrënjor i fidanit. Në rast se ka rrënjë të përdredhura, ato shkurtohen me kujdes me gërrshërë të posaçme.

Fidani vendoset në qendër të gropës, në mënyrë që të ruhet skema e mbjelljes. Qafa e rrënjës së fidanit të jetë 2-3 cm nën nivelin e pjesës së sipërme të gropës. Gropa mbushet me dhe anash fidanit duke e ngjeshur herë pas here me kujdes, në mënyrë që të sigurohet kontakti i rrënjëve me dheun e hedhur në gropë. Gjatë mbushjes së gropës me dhe bwhet ngjeshja, të tregohet kujdes në mënyrë që fidani të ruhet i padëmtuar. Pas mbjelljes së fidanit, dheu do të ngjeshet me kujdes, në mënyrë që të eliminohen fluskat e ajrit të tokës të cilat influencojnë negativisht në drejtim të zënies së tij. Në zona të thata, sipërfaqes së gropës i jepet formë konkave, ndërsa në ato pjesë ku toka mund të mbajë lagështi, formë konvekse. Gurët që rezultojnë gjatë mbushjes së gropës, vendosen në pjesën e poshtme të saj në formë muri, në mënyrë që të mbrojnë terrenin nga erozioni.

Afatet e kryerjes së punimeve, lloji dhe cilësia e fidanëve si dhe teknika e zbatimit të punimeve gjatë mbjelljes, do të zbatohen dhe gjatë procesit të zëvendësimeve, i cili do të kryhet vitin e dytë pas mbjelljes.

3.5. Koha e kryerjes së punimeve:

Punimet përgatitore (Piketimi dhe hapja e gropave) do të kryhen gjatë muajve Nëntor-Dhjetor, ndërsa procesi i mbjelljes do të bëhet gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit (Nëntor-15 Mars).

Rekomandohet që mbjellja e fidanëve të bëhet brenda një kohe sa më të shkurtër nga hapja e gropave, për të monitoruar në mënyrë korrekte kryerjen e punimeve.

Sigurimi i materialit mbjellës (fidanëve) duhet të bëhet para se të fillojë hapja e gropave, rekomandohet nga muaji Tetor për arsyeën që kur të hapen gropat të mos kemi vonesa. Shkulja e fidanëve nga fidanishtja, transporti, shtrifikimi në objekt dhe mbjellja e tyre duhet të bëhet vetëm në periudhën e pushimit të vegjetacionit.

3.6. Parashikimi i përqindjes së zënieve për periudhën Qershor-Shtator:

Përqindja e zënieve parashikohet në pranverë 90% dhe në vjeshtë 80 %. Në funksion të përqindjes së zënieve të vjeshtës, përcaktohet numri i fidanëve që do zëvendësohen. Zëvendësimi i fidanëve të tharë, do të bëhet sezonin pasardhës të mbjelljeve. Sasia e fidanëve që do të zëvendësohen është e njëjtë me numrin e atyre që janë tharë.

Objekti parashikohet që të mirëmbahet për 3 vite. Në fund të vitit të tretë, në mënyrë që pyllëzimi të jetë i suksesshëm, përqindja e zënieve parashikohet të jetë $\geq 80\%$.

3.7. Shërbimet kulturore dhe ruajtja:

Pas përfundimit të pyllëzimeve në vitin pasardhës do të kryhen zëvendësime në masën 20% për fidanët e dështuar në vitin e parë si dhe pas monitorimit dhe verifikimit të zënieve (të vjeshtës) në muajin shtator.

Prashitja e fidanëve si dhe heqja e barërave të këqija do të bëhet në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të mbjelljes. Prashitjet do të shoqërohen me plehërim kimik (Dap ose Nitrat), duke përdorur rreth 50 kg/ha për çdo prashitje. Fillimisht hidhet nga një dorë pleh duke përdorur rreth 20-25 gram për çdo fidan, pastaj kryhet procesi i prashitjes. Duhet patur kujdes që plehu të hidhet vetëm për sasinë e fidanëve që mund të prashiten brenda ditës pasi në rast se ai mbetet i pa mbuluar, i humbet elementët ushqyes për bimën.

Prashitja bëhet me vegla të thjeshta pune (Shatë), duke u përshtuar me punime sipërfaqja rreth fidanit me rreze 0.3 m nga fidani e thellësi 10 - 15 cm. Gjatë prashitjes të bëhet shkriftimi i dheut dhe heqja e bimëve barishtore

Koha e kryerjes së prashitjeve do të jetë periudha Qershor - Korrik. Rekomandohet që prashitjet të bëhen 2-3 ditë pas rënies së shirave ose uitjes, në mënyrë që të ruhet sa më shumë lagështira në gropë. Objekti duhet të mbrohet nga kullotja për 3 vjet dhe në rast të shfaqjeve të dëmtuesve apo sëmundjeve duhet të bëhet luftimi i tyre. Të gjitha këto punime, do të jenë pjesë e investimit të këtij objekti, duke ndikuar në sigurimin e përqindjes së zënies së planifikuar dhe zhvillimin e mëtejshëm të grumbullit pyjor. Subjekti i kontraktuar në bashkëpunim me Strukturat Menaxhuese të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Bashkisë Himarë, komunitetin e zonës, të marrin masat e nevojshme administrative për mbrojtjen e objektit nga kundravajtjet, zjarret dhe kullotje për një periudhë 3 vjeçare.

3.8. Grafiku i kryerjes së punimeve:

Partneri kryesorë për zbatimin e projektit është subjekti "ABEILLE'S RESORT", specialistët e Bashkisë Himarë. Stafi i subjektit të kontraktuar në bashkëpunim me strukturat drejtuese të fshatrave në afërsi të objektit, do sigurojë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve të planifikuara. Drejtuesi teknik i subjektit, do bëjë trajnimin punëtorëve për mënyrën e kryerjes së proceseve të punës sipas planifikimit. Ritmiksht gjatë kryerjes së punimeve, nga ana e stafit teknik do të mbahen marrëdhënie me specialistët e Bashkisë Himarë.

Drejtuesi Teknik i subjektit të kontraktuar, do të organizojë kontrolle për cilësinë e kryerjes së punimeve dhe në rast konstatimi të metash, lihen detyra për përmirësim.

Punimet e planifikuara, fillojnë mbas lidhjes së kontratës e trajnimit të punëtorëve.

Në formë tabelare, grafiku paraqitet si më poshtë:

Aktiviteti	Muaji							Grupi i implementimit
	<i>(kutitë e selektuara tregojnë aktivitetet e planifikuara, nga muaji i parë i zbatimit të projektit)</i>							
	1 0	1 1	1 2	1 1	2 2	3 3	4 4	
A1.Njohja me objektin ku do të realizohen punimet.	x							Bashkia Himarë, Stafi drejtues i subjektit ABEILLE'S RESORT
A2.Sigurimi i fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve.	x	X						Stafi drejtues i subjektit
A3.Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve.	x	x	x					Stafi drejtues i subjektit dhe drejtuesi teknik.
A4.Piketimi sipas skemës së mbjelljes.		x						Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A5.Hapja e gropave dhe kontrolli i cilësisë së tyre.		x	x					Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A6.Sigurimi, transporti, shtratifikimi i fidanëve cilësorë dhe të certifikuar.			x	x				Stafi i subjektit të kontraktuar
A7.Mbjellja e fidanëve, duke respektuar teknikën e zbatimit të punimeve.			x	x	x	x		Stafi i subjektit, drejtuesi teknik, punëtorët e trajnuar.
A8, Kontrolli i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës.		x	x	x	x	x	x	Grupi i monitorimit (Specialistët e Bashkisë Himarë, Drejtuesi Teknik i subjektit).

4.1. Analiza e Riskut:

Rreziqet më të mëdha për mos funksionimin dhe realizimin e këtij projekti, janë mungesa e fidanëve, konflikti për vendin ku do të pyllëzohet etj. Në kuadrin e një analize të plotë dhe të gjithanshme të vlerësimit të të gjithë faktorëve që ndikojnë në përkeqësimin e tregueseve të performancës dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të objektit të pyllëzimit do të konsideronim si faktorë rrisht:

- Cilësinë e kryerjes së punimeve dhe materialit mbjellës (*Fidanëve pyjorë*).
- Kushtet ekstreme të motit (Ekzistenca e një periudhe të gjatë kohe pa reshje (≥ 2 - muaj) dhe temperaturat ekstreme të larta apo të ulëta).
- Dëmtimi i objektit nga kullotja e bagëtive apo i qëllimshëm.
- Prania e ndonjë zjarri eventual dhe të rastësishëm.
- Mosrealizimi i shërbimeve kulturore të planifikuara.

Pra, duke parë me kujdes faktorët e mësipërm të cilët çojnë deri në kompromentimin e ekzistencës së objektit të pyllëzimit, përfituesi i objektit duhet të marrë masat e duhura tekniko- organizative, për zbutjen apo eliminimin e faktorëve të riskut si dhe mbrojtjen e objektit për një periudhë 3 vjeçare. Kjo nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave pyjore të Bashkisë Himarë, si dhe sensibilizimit e ndërgjegjësimit të komunitetit për mbrojtjen e objektit nga zjarret, prerjet abuzive dhe kullotja.

4.2. Qëndrueshmëria e projektit:

Në arritjen e objektivave të planifikuara në këtë projekt Agropjlltarie, atë të mbjelljes së fidanëve arrorë të llojit: Arre, do të ndryshojë qeverisja e kësaj parcele, do të shtohet fondi pyjor, volumi i lëndës drusore, sipërfaqja e trungishteve, si dhe do ketë aktivitete të tjera si zëvendësime prashitje ujitje. Grumbulli pyjor që do të krijohet, i trajtuar sipas projektit, në aspektin e funksionalitetit dhe të qëndrueshmërisë, do të sjellë në vazhdimësi rritje të vlerave ekonomike, ku përfshihen, krijimi i kushteve për shtimin e faunës dhe florës, përfitimet në stokimin e karbonit si dhe përfitime ekonomike në të ardhmen nga prodhimet e dyta (frutat) dhe lënda drusore që rezultojnë nëpërmjet trajtimeve e ndërhyrjeve silvikulturore dhe ekologjike të tij.

Egziston mundësia e sigurimit të fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e volumit të punimeve të planifikuara nga komuniteti i fshatrave në afërsi të objektit si dhe i materialit mbjellës (Fidanëve) sipas standartit të kërkuar. E parë në këtë kontekst, mendojmë se ky projekt paraqet qëndrueshmëri dhe vazhdueshmëri e tij në të ardhmen, do jetë e garantuar.

Qëndrueshmëria për aktivitetet e propozuara do të varet nga:

- cilësia e kryerjes së punimeve të planifikuara dhe zbatimi i afateve.
- kryerja me korrektësi e punimeve të mbjelljes dhe shërbimeve kulturore.
- ruajtja e objektit nga rreziqet e mundshme e dëmtimet e ndryshme.

4.3.Ndikimi social-ekonomik:

Gjatë realizimit të këtij projekti, do të ketë mundësi punësimi për banoret e fshatrave në afërsi të objektit duke përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhura ekonomike për buxhetet e tyre familjare, uljen e nivelit të papunësisë dhe varfërisë së komunitetit.

Gjithashtu realizimi i këtij projekti shoqërohet dhe me vlera të veçanta për zonën në aspektin social dhe rekreativ, pasi pas disa vitesh,kjo do të shoqërohet me të ardhura për zonën si,shtim të materialit drusor,rritje të masës së gjelbërt në këtëterritor,përmirësimtë strukturës së tokës,frenimin e humbjes së mëtejshme të tokës nga rrëshqitjet, krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e florës dhe faunës autoktone, më shumë karbon i stokuar,cilësi më të mirëtë ajrit,ujrave, etj.

Të gjitha këto, sjellin pozitivitet në kuadër edhe të një mjedisi më të pastër, përmirësimin e peizazhit si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor.

4.4.Buxheti i planifikuar

Për realizimin e punimeve të planifikuara në këtë projekt, bazuar në manualin e normave "Normat e punës me krahë dhe me kafshë për punimet bujqësore e pyjore" miratuar nga Ministria e Bujqësisë në vitin 1986.

Të dhënat sipas modelit teknik të punimeve janë:

4.5. Kohëzgjatja e projektit:

Vlerësimi i kohëzgjatjes së projektit	120 muaj
Data e fillimit të projektit	2022-2031.
Data e përfundimit të projektit	2031
Vlerësimi i buxhetit per 1 ha drur pyjore	± 658166Lekë
Vlerësimi i buxhetit per 1 ha drur arror	±247122

4.6.Vlerësimi dhe Monitorimi:

Indikatorët kryesorë teknikë dhe mjedisorë që do monitorohen gjatë zbatimit të punimeve dhe mirëmbajtjes së objektit janë:

1. Numri i drurëve për Lisin në 1 ha i cili do të jetë 1667 fidanë/ha
2. Përmasat e gropave për Arren do të jenë 60 x 60 x 60cm.

3. Parametrat teknikë dhe cilësorë të fidanëve që do përdoren gjatë mbjelljes.
4. Zbatimi i afateve të realizimit të punimeve.
5. Zbatimi i kritereve teknike gjatë procesit të mbjelljes.
6. Monitorimi i zëvendësimeve dhe shërbimeve kulturele të planifikuara.

Ndikimet në mjedis gjatë kryerjes së punimeve të pyllëzimit të sipërfaqes në ngastrat pyjore 69 ndahen në:

- ndikime gjatë zbatimit të punimeve.
- ndikime pas përfundimit të punimeve.

Këto ndikime përfshijnë mjedisin ekologjik, fizik si dhe faunën e zonës. Ndikimet negative të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut, gjatë fazës së zbatimit dhe fazës së operimit janë jetëshkurtër dhe do të zhduken kur projekti të përfundojë. Kështu gjatë kryerjes së punimeve disa nga ndikimet në mjedis do të jenë:

- Punimet përgatitore për mbjellje dhe ndërtimi i rrugëve brenda ngastrës pyjore do të sjellin nxitje të erozionit të tokës në një masë të kufizuar.
- Përdorimi mjeteve të transportit si dhe makinerive për kryerjen e punimeve do të shkaktojnë ndikime në emetimin e gazeve serë nga djegia e karburantit.
- Po kështu zhurmat gjatë kryerjes së punimeve janë një tjetër ndikim negativ që do të shkaktohet në mjedis, duke sjellë shqetësime edhe për faunën në objektin e pyllëzimit.
- Plehurat kimike të përdorur gjatë mbjelljes dhe shërbimeve kulturele, mund të ndikojnë negativisht në kontaminimin e tokës dhe ujrave, prandaj duhen përdorur me kujdes dhe duhen hedhur nësasinë e nevojshme.

Ndërsa ndikimet pas përfundimit të punimeve, në përgjithësi konsiderohen si ndikime pozitive në mjedis sepse:

- Pas përfundimit të projektit, shkalla e mbulimit të vegjetacionit do të rritet dhe do të sigurohen përfitime mjedisore, për shkak të rritjes së nivelit të shërbimeve në mjedis që ofron pylli i krijuar.
- Do të rritet kapaciteti i strehës dhe ushqimit për faunën në objekt
- Kryerja e pyllëzimit do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e tokës
- Grumbulli pyjor i krijuar do të rrisë kapacitetin absorbues të gazeve serë e sekuestrimit të karbonit.
- Do të kemi një përmirësim të mjedisit ekologjik.

KAPITULLI V

ANEKSE

5.1 PLANIMETRIA E PARCEL

5.5.Përshkrimi i llojit që do të përdoret për pyllëzim:

5.5.Përshkrimi i llojit që do të përdoret për pyllëzim:

Arra (Juglans regia)

Origjina dhe përhapja

Ky plan pjesor synon marrjen e masave preventivuese për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të sipërfaqeve pyjore, e kullimore, të çveshura, rehabilitimin, përmirësimin, shtimin dhe masat mbrojtëse të ekosistemeve natyrore, vlerësimin e burimeve pyjore. Në këtë mënyrë do të arrihet që të përpunohen më mirë kapacitetet prodhuese të resurseve natyrore me plotësimin e kërkesave të banorëve të bashkisë për lëndë ndërtimi, dru zjarri, bazë ushqimore për blegtorinë, kullotjen e blektorisë si dhe do të rriten e përdoren më mirë dobitë e tjera që vijnë si rezultat i një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të bashkisë dhe burimeve të tjera natyrore. Vetë territori i Bashkisë Himarë shtrihet në të dy anët e lumit Shushice deri në detin Jon.

2.1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor: Të sigurojë një menaxhim të qëndrueshëm për një pjesë të terrreneve pyjore e kullimore që gjenden në pronësi të Bashkisë Himarë. Ky pozicionim jepet në hartën në këtë material.

Objektivi Përgjithshëm: Hartimi i planit të mbarështrimit pjesor për pyjet dhe kullotat e Bashkisë Himarë, për realizimin e përdorimit të qëndrueshëm të pyllit dhe kullotës.

2.1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Plani i Mbarështrimit Pjesor hartohet për disa ngastrave pyjore e kullimore prona të Bashkisë Himarë, të cilat kanë energjencë për tu rishikuar mbasi nga vet komuniteti i zonës janë shprehur interes për rivlerësim të tyre. Rivlerësimi bëhet qoftë në aspektin sasior (të sipërfaqes, kapacitetit të burimeve) po ashtu edhe cilësor (rritja e frekuentimit për shkak të përmirësimit të infrastrukturës rrugore). Ky mbarështrim pjesor prek ngastrave pyjore në Nj.A. Hore-Vranisht, fshat Kuc, Bashkia Himarë, Vuno, dhe Himarë dhe në Nj.A. Lukovë.

2.1.3. Metodologjia e Punës

Grupi I punës për hartimin e këtij plani mbarështrimi pjesor përbëhet nga specialist pyjesh dhe konkretisht

1-Ilia Gjika, Drejtor I Drejtorisë të Menaxhimit dhe Mbrojtjes të Tokës,Pyjeve dhe Kullotave.
2 Ilia Dhimojani, Përgjegjës Sektori,3 Pavli Curraj, Inspektori I zonës.

Procesi kalon në këto aktivitete:

- Vlerësimi i vlefshmërisë të afateve të Planeve të mëparshme të mbarështrimit apo inventarizimit.
- Listimi i ngastrave pyjore apo kullosore që janë object I planit te mbarështrimit pjesor.
- Punimet në zyrë (të dhënat paraprake, hartat paraprake, njohja me kuadrin ligjor ,planifikimi I aktiviteteve , sigurimi dhe garantimi i paisjeve për punime në zyrë, paisjet e terrenit, mjetet për matjen dhe grumbullimin e të dhënave, automjetin lëvizës etj).
- Punimet në terren ,grumbullimi I të dhënave.
- Hedhja dhe përpunimi I të dhënave në zyrë.
- Nxjerja dhe vlerësimi I rezultateve paraprake.
- Rishikimi dhe nxjerrja e rezultateve përfundimtare, përgatitja e materialit të shkruar në ëord, excel,pdf, dhe përgatitja e hartave.
- Përgatitja e Draft Raportit Final
- Dorëzimi i Draft Planit te Mbarështrimit Pjesor të pyjeve dhe kullotave pronë e Bashkisë Himarë për miratim në Këshillin Bashkiak Himarë .

2.1.4. Informacioni i perdorur ne hartimin e PMPK

Për hartimin e planit te mbarështrimit pjesor u përdor informacioni I mëposhtëm:

- Ligji 57/2020"Per Pyjet", ligjit 9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullosor", i ndryshuar,
- VKM nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkise te Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listes se inventarit dhe aktualisht të administrimit të Ministrisë se Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", i ndryshuar, VKM 104 dt.05.02.2020
- Informacioni nga planet e meparshme te menaxhimit dhe te inventarit te pyjeve te vitit 1985,2002 si dhe inventarit të mëparshëm në kullota.
- Informacioni hartografik në planet e menaxhimit te mëparshëm dhe në inventaret e mëparshme të pyjeve dhe kullotave.
- Informacioni nga kadastra e pyjeve dhe e kullotave prane bashkisë Himarë.
- Informacionet që ndodhen ne zyrën e pyjeve në bashki për titujt e pronësisë private në fondin pyjor e kullosor .
- Kërkesat për shprehje interesi të komunitetit të zones dhe Njesise administrative per kullotjen e bagetive te fermes se tyere.
- Udhëzimi për hartimin e planeve të mbarështrimit
- Të dhënanga Zyra e Gjëndjës Civile Himarë .
- Eksperienat e mëparshme në hartimin e planeve të mbarështrimit dhë studimeve te ndryshme në pyje dhe kullota.

2.2 PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISË PYJORE.

2.2.1. Informacion i pergjithshem rreth Ekonomise pyjore

Bashkia e Himarë s ka një sipërfaqe të territorit të saj prej 399.6 km² dhe me nje popullsi afersisht 27.000 banor. Qendra e bashkisë është qyteti I Himarë s. Territori I bashkisë Himarë shtrihet në Qarkun Vlorë, në të dy anët e Lumit te Vlores deri ne bregun Jon.

Plani I Mbarështrimit Pjesor u hartua për nje parcele pyjore në Ekonomine pyjore Mali I Pilurit-Cike dhe në tabelën e mëposhtme jepen te dhëna për sipërfaqen totale të tyre dhe afatin e vlefshmërisë te këtij plani mbarështrimit pjesor:

Ngastra nr	Ekonomia pyjore/Kullosore	Siperfaqe ne sipas VKMM ne Ha	Vlefshmëria e Planit të Mbarështrimit Pjesor
69	E.P. Mali I Pilurit-Cike	45.3	2023-2032

Në planet e mbareshtimit dhe inventarizimit te pyjeve dhe të kullotave të mëparshëm situata ishte si më poshtë:

Ngastra nr	Ekonomia pyjore/Kullosore	Sipërfaqe ne Ha (nga Inv. e më parshme)	Emri popullor
69a	E.P. Mali I Pilurit-Cike	29.3	Lajbardhat
69b	E.P. Mali I Pilurit-Cike	6.25	Lajbardhat
69c	E.P. Mali I Pilurit-Cike	16	Lajbardhat

Arsyet e hartimit të Planit te ri të mbarështrimit pjesor janë:


- Planet e mbareshtimit te meparshëm kanë mbaruar afatin e vlefshmërisë, një pjesë e ngastrave te ekonomive pyjore dhe kullosore ishin me të dhëna nga inventari vitit 1981 , 1985 dhe vitit 2002.
- Rivlersimi bëhet qoftë në aspektin sasior (të sipërfaqes, kapacitetit të burimeve) po ashtu edhe cilësore (ritja e frekuentimit për shkak të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe kerkeses per kullotjen e bagetvi komunitetit te zones dhe per aktivitete turistike,kampingje).

2.2.2. Pronesia, administrimi dhe organizimi

Ngastrat pyjore dhe kullosore object I këtij plani mbarështrimit pjesor janë në territorin e Bashkisë Himarë dhe janë në territorin dhe pronësi të kësaj bashkie. Ato amdinistrohen dhe menaxhohen nga vet bashkia dhe përdorues janë familje në fshatrat në territorin e të cilave ndodhen këto ngastra. Deri më sot këto sipërfaqe janë përdorur për prodhimin e druve të zjarrit, kullotjen e bagëtivë , grumbullimin e bimëve medicinale. Përdorimi është kolektiv .

2.2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ngastra nr	Ekonomia pyjore/Kullosore	Siperfaqe sipas VKMM ne Ha	Pronësia
69	E.P. Mali I Pilurit-Cike	45.3	Bashkia Himarë



2.2.4. Konteksi i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Bashkia Himarë ndodhet në Qarkun e Vlores dhe është krijuar nga ish bashkia Himarë, ish Komunitat Hore-Vranisht, Lukovë, etj. Qendra e bashkisë është qyteti i Himarës. Vet Bashkia Himarë kufizohet me bashkinë Vlorë, Selenicë, Sarandë dhe qarkun e Gjirokastrës. Ekonomitë pyjore e kullimore në territorin e kësaj bashkie. Ngastrat objekt i këtij Plani Pjesor Mbarështrimi, nuk përfshihen në zona të mbrojtura. Banorët në këtë trev janë të angazhuar kryesisht me turizmin, blejktorinë, përgjatë luginës të lumit të Vlores me bujqësinë, tregtimin e prodhimeve blektorale e bujqësore si dhe me emigrimin.

2.2.5. Historiku i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore e Kullimore.

Ekonomitë pyjore e kullimore, Mali i Cipinit-Gike i këtij plani mbarështrimi pjesor, kanë pasur plane menaxhimi të vitit 2002-2009 dhe plane inventarizimi të vitit 1981 dhe 1985. Gjatë gjithë këtyre viteve ka pasur ndryshime në sipërfaqe për shkak të pronësisë, dëmtimit dhe ndërhyrjet me prerjet në vite, rritja e mbulesës në përqindje me shkurrë dhe bimësi pyjore në kullota si rezultat i mosbërhyrjeve me pastrime, etj.

2.2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike

Bashkia Himarë ka gjithsej rreth 27.000 banorë e shtrire në tre Njese Administrative: Himarë, Lukovë, Hore-Vranisht. Ka akoma një tendencë për tu larguar drejt metropolit ose jashtë vendit. Në popullsinë prezente dominon moshë mbi 45 vjeçe. Megjithatë në zonat e fshatrave banorët janë të angazhuar me turizmin, bujqësinë dhe blejktorinë dhe më aktivitetet e ngjashme në pyje dhe kullota.

2.2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore

Në ngastrat e ekonomisë pyjore në këtë studim nuk ka patur aktivitete të mirfillta të shfrytëzimit të materialit drusor, por vetëm për nevojat e komunitetit të zones dhe institucioneve, shkollave. Si e tillë nuk ka patur dhe nuk ka strukturë pyjore (Baraka, magazine, gatra, sharra etj). Punëtorët lokal mund të punojnë në ndërhyrjet e mundhme me punime në pyje dhe kullota.

2.2.8. Gjuetia dhe peshkimi

Në Ekonomitë e këtij plani mbarështrimi pjesor gjendet specie autoktone të faunës si Lepuri I egër (Lepurus europea), ujku (canis lupus) etj. Nga shtegtarët mund të përmëdim Shapktoren (sculopatus Sculopatus), Kali I Qyqes, lauresha etj. Ky territory përshkohet nga lumi I Vlores. Nga peshqët mund të përmëdim Pestrovën, Mustakun, Lundra etj. Banorët kryesisht të qytetit Himarë kanë një traditë në peshkimin sportive. Gjithashtu, përpara moratoriumit të gjuetisë ka patur eksperiencë të gjuetisë turistike. Për faunën dhe peshkimin është e domosdoshme të parandalohet gjuetia e paligjshme, dhe me mjete shfarosëse.

2.2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike

Në territorin e Bashkisë Himarë në ka pika të ndryshme për destinacion turizmi dhe pushimi si p.sh. Kalaja e All Pashës, destinacion kryesor është deti Jon. Gjithashtu me përfundimin e rrugës të lumit të Vlores pritet rritja e frekuentimit të turizmit malor në këto zona. Rritja e këtij aktiviteti do të sjellë punësimin e banorëve të moshave e gjinive të ndryshme.

2.2.10. Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

Zonat e mbrojtura nuk ndodhen në ngastrat e marra në këtë studim.

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1. MBARËSHTRIMI DHE FUNKSIONET E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual & propozimet)

Po japim më poshtë një informacion të shkurtër për sipërfaqen e ekonomise pyjore sipas kategorive të përdorimit të territorit si dhe propozimet për ndryshimet respektive:

Emri i Ekonomise	Përdorimi i territorit	Pyll	Tok me bim. Pyjore	Bujqesi	Kullote, livadh	Djerr	Joproductive
E.P. Mali i Cikes-Cipin	Aktual	29.3		6.25	16		
	Propozimi	29.3			16	6.25	

Ka ndryshime për shkak të rimatjes dhe ndryshimeve në pronësi.

3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet).

Është shkurre dhe tokë me bimesë pyjore.

3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore në parcella dhe nenparcella

Ndarja në ngastra dhe nënngastra u bë duke iu referuar kufijve të qartë natyrore apo artificial, si dhe u mbajtën parasysh kufijtë në palnetë e inventarizimit apo mbarështrimit të mëparshëm.

Në formë tabelare listën e të gjitha parcellave dhe nenparcellave që përbejnë ekonomitë pyjore është sipas tabelës së mëposhtme.

Ek pyjore	Ngastra	n/ngastra	Kodi ngastrës	Pronari	sipërfaqja	Bashkia	Nj.A.	Z.Kadastrale
Mali i Pilurit-Cike	69	a	VI 3500 069a	Bashkia Himarë	29.3	Himarë	Hore-Vranisht	3823
Mali i Pilurit-Cike	69	b	VI 3500069b	Bashkia Himarë	6.25	Himarë	Hore-Vranisht	
Mali i Pilurit-Cike	69	c	VI 2400 118	Bashkia Himarë	16	Himarë	Hore-Vranisht	

1.1.4. Funkcioni i grumbujve pyjore

Grumbujt e pasurisë të mare në studim kanë kryesisht funksion prodhues. Funkcioni prodhues është për prodhim dru zjarri për materialin që do të vilet nga nderhyrjet përmirësuese me prerje shëndetësive, rrah.

Ek pyjore	Ngastra	n/ngastra	Kodi ngastres	siperfaqja	Funksioni
Mali i Pilurit-Cike	69	a	VI 3500 069a	29.3	Prodhues

4. KUSHTET STACIONALE

4.1. KLIMA

Faktoret qe ndikojne ne formimin e klimes se kesaj zone jane:

- Pozita gjeografike e saj qe karakterizohet me depertim te rrymave detare permes lugines se lumit te Vlores, dhe detare te detit Jon, si dhe ndikimi i aktivitetit ciklonar dhe anticiklonar malor gjate periudhes se dimrit.
- Relievi i shumellojshem dhe drejtimi i percaktuar i vargjeve malore dhe lugines kryesore te lumit te Vlores dhe luginave te tjera te gjata e te larta.
- Ndikimi freskues i ererave kontinentale te maleve të larta e grykave të thella gjate periudhes se veres.

Territori i Bashkisë Himarë bën pjese ne zonen mesdhetare para malore e malore, nenazonen mesdhetare malore jugore, me diferencim te metejshem te mikroklimes si rezultat i heterogjenitetit te shtreses siperfaqesore. Per studimin e elementeve te vecante te klimes te kesaj zone jemi mbeshtetur ne te dhenat e sacionit meteorologjik Vlore, ne botimin e Institutit Hidrometeorologjik te vitit 1988 "Vecorite Agroklimatike te Rrethit te Himarë s", në studimet për klimën e agro – meteorologjinë, si dhe nga vrojtimet ne terren te bera nga grupi i punes.

- Ererat:** Ne klimen e kesaj zone nje ndikim te madh pervec vendodhjes ne nje territor kodrinoro – malor, kane ererat detare dhe ato te veriut. Territori i Bashkisë Himarë fillon nga vija bregdetit Jon dhe rreth 40 km larg vijes bregdetare influenca e plote e te cilit kufizohet nga vendosja Veri-perendim – Jug-lindje te vargmaleve te Cikes, Cipinit, Bolenes etj. Era jugore e cila deperton nepermjet grykes se lumit shpesh arrin ne 40 m/sek ose rreth 150 km/h, duke u klasifikuar me ererat e rrembyeshme me pasoje shkaterruese per bimesine e kultivuar te zones. Pasojat jane me te renda nese keto erera jane te ngrohta e te thata. Nga ana veriore ne luginen e lumit te Vlores vijne ererat veriore te ftohta e te forta, por me rastesi me te pakta se ererat jugore. Nga drejtimi veri-lindor e jug-lindor ererat jane me te rralla, për shkak të mbrojties nga malet .Nga perendim ererat detare.
Ne kete zone fryjne erera per me se 55 dite ne vit, duke qene nje nga krahinat me me shume dite me erera te vendit.

Tabela me te dhena per Ererat

Muajt	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	Dh
Drejtimi	J	V	J	J	J	J	P	V-P	V-P	J	J	J-P

Eres	J-P	V-P	J-L			J-P	J-P				J-P	
Shpejtesia	10	14	40	28	40	20	17	18	14	117	34	30
m / sek												

Ererat e jugut te muajit Mars e Maj kane shpejtesi maksimale 140 – 150 km/h, por qe fatmiresisht nuk vazhdojne me shume se 24 ore. Ndikimi i madh i ketyre ererave jugore dhe thatesira me e theksuar ne shpatet me te njejtin kundrejtim, ka bere qe ne shpatet me kundrejtim jugor te maleve te kete me pak bimesi pyjore.

b. Reshjet: Pjesa e ulet ne veri te zone karakterizohet nga nje vere e nxehte dhe e thate e me shira te paketa (Qershor 36.5 mm, Korrik 36.4 mm e Gusht 27.8 mm), kurse ne pjesen kodrinore te larte dhe ne ate malore ajo eshte mjaft e fresket. Por duhet te theksojme se ka dhe mjaft mikroklima sidomos ne zonen malore, pergjate Lumit te Vlores e per rreth burimeve ujore, etj qe e bejne klimen gjate veres mjaft interesante e te fresket si ne fshatrat e larta. Vjeshta, dimri e pranvera jane me rreshje te shumta perkatesisht 291.1, 733.6 dhe 400.3 mm. Keshtu qe reshjet vjetore arrijne deri ne 1425 mm por shperndarjet jane te cregullta. Keto te dhena tregojne se rreshjet qe bien ne Bashkinë Himarë jane shume te larta dhe bejne qe te futet ne zonat me rreshje vjetore mbi mesataren ne Shqipëri. Ky eshte faktori kryesor i nje zhvillimi te vrullshem te bimesise dhe i burimeve te shumta ujore. Reshjet e debores jane me te rralla ne lugine e me te shpeshta ne zonen malore mbi 900 m mbi nivelin e detit, e ne disa male e maja qendron per nje periudhe me te gjate.

c. Temperturat: Per marrjen e te dhenave lidhur me temperaturat dhe rreshjet i jemi referuar stacionit meteorologjik Himarë . Temperaturat mesatare mujore e vjetore, si dhe sasia e rreshjeve respektive jepen ne pasqyren e meposhteme.

Tabela e Elementeve Klimatik

Muajt	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	Dh	Mesatar e Vjetore
Temp. Mes. Mujore C ⁰	6.0	8.1	11.4	14.6	19.1	23.0	24.8	22.8	19.8	14.5	9.3	7.9	16
Temp. Max. Absolute C ⁰	18.5	22.4	23.2	26.4	31.8	35.8	41.2	36.8	34	28.7	22.1	19.3	
Temp. Min. Absolute C ⁰	-7.5	-8.5	-3.9	0.6	3.6					1.6	-3.3	-4.8	

Shuma Temp.	43	53	129	302	503	610	691	691	581	428	196	74	4301
Aktive													
Rreshjet mm	200.4	179.5	112.8	87.5	90.5	36.5	36.4	27.8	76.3	119	234.8	223. 5	1425
Lag. Relat.	61	58	59	57	56	51	52	50	54	56	60	68	56
Ajrore ne drek													

Nga studimi i te dhenave klimatike shume vjecare vihet re se ka rritje te lehte te tre elementeve te temperaturave: maksimale, mesatare mujore dhe absolute maksimale, sikurse edhe rrezatimi diellor ne keto 20 vitet e fundit. Edhe temperaturat minimale, si ato mesatare dhe absolute jane ne rritje te vogla si rrjedhoje e demtimeve te renda pyjeve nga prerjet pa kriter dhe djegieve te pyjeve fletore, kryesisht me shkurre e dushqe. Lageshtia relative e ajrit vjen ne ulje. Renia e breshrit ne pranvere jo rrall here ka shkaktuar deme ne frutikulture e bujqesi.

Gjithashtu ka ndryshime te dukshme ne raportin rreshje shiu me rreshje debore, me rritje te rreshjeve te shiut. Rreshjet e bores kane ardhur ne ulje. Nje gje e tille ndikon ne uljen e prurjes se ujit te burimeve te shumte gjate veres. Nuk ndikojne përmbytjet në këtë territor.

Duke patur parasysh shtrirjen vertikale te bimesise e cila fillon ne kuoten 100 m ne lumin e Vlores deri ne lartesine e malit te Karaburunit, Cikes etj dalin qarte edhe formacionet bimore sipas zonave fitoklimatike, te cilat dallohen per parametra klimatike te vecante.

Ne fund te pjeses se shkruar jepet harta e nen zonave klimatike te rrethit te Himarë s.

4.2. TOPOGRAFIA DHE MORFOLOGJIA

Relievi i bashkise Himarë shtrihet nga niveli rreth 0m mbi nivelin e detit deri në majën më të lartë të Malit të Cikës 2045 m. Terreni është kodrinor, paramalor dhe malor. Peisazhi është i formuar nga ter lumenjë me luginat e tyre, dhe nga mallet Këndrevice, Mali Cikes, Karaburunit, etj. Në përgjithësi Ekonomitë pyjore janë të vendosura në shpate malesh dhe kodra. Planifikimi afatgjat është i qëndrueshëm. Por duke qenë zona të prekura nga emigrimi dhe migrimi, planifikimi afat gjat për përdoruesit është i vështirë është i vështirë.

4.3. GJEOLGJIA

Ne pjesen me te madhe jane pak a shume formacione te njejta Gelqerore. Keshtu malet ne pjesen veri-lindore kufi me Himarë n, ne jug jane te perbera nga formacione gelqerore, me shpate te zhveshura nga bimesia e te copëtuara nga erozioni.

Me ne veri dhe rrëzë maleve fillojnë kodrat, te cilat jane te zhveshura dhe shume te coptuara. Në pjesën qendrore të Lugines rrëzat e maleve dhe kodrat e shumta në përgjithësi janë

të veshura kryesisht me pyje fletorë. Territori i madh kodrinor në të dy anët e lumit të Vlores deri në kufirin ndarës me Bashkitë kufitare përbëhet në pjesen me të madhe prej formacioneve të buta si: shtufe dhe argjila, prandaj dhe gerryerja e cvendosja e materialeve të ngurta nga lart – posht është e madhe. Nga këta male dalin rreke të shumta të cilat depozitohen në lumin e Vlores. Pjesa kodrinore rreze maleve të mesiperm përbehet nga argjila dhe pjesërisht ranore.

Në perëndim zona rrethohet nga malet e Kurveleshit dhe Karaburunit të perbera nga formacione gelqeroresh dolomitik me thjerrza strallore e me çarje të shumta. Erozioni është shumë i fuqishëm në pjesën e mesme e në shpatet e pjerreta. Një përhapje të madhe kanë këtu reshqitjet shkembore, shembjet, rrezimet, krijimi i brazdave dhe i koneve të depozitimit. Kodrat në rreze të maleve janë formacione ranore e flyshe.

Në Qendër të zonës shtrihet lugina e Vlores që përshkon mbi formacione gelqerore në pjesën e sipërme dhe përbehet nga formacione flyshore të buta e ranore në pjesën e poshtme. Si konkluzion këto zone e dominojnë formacionet gelqerore e me pak ato shtufore.

4.4. TOKAT

Të dhënat e përshkrimit të tokës janë marrë nga studimet pedologjike për Bashkisë Himarë, duke i kombinuar ato me të dhënat konkrete të nxjerra nga sondazhet gjatë ekspeditimit të grupit të punës. Mbeshtetur në kriteret pedologjik kryesor, në këto zone mbizotrojnë tokat subargjilore të mesme (SAM) me përmbajtje gëresh të madhësive të ndryshme që variojnë nga ϕ 0.1 – 3 cm. Thellessia e shtresës aktive (profilin) sipas zonalitetit vertikal fillon me toka mesatarisht të thella e me ujrat freatike të cekta dhe vazhdon të dallohet shtresa aktive e të ulen ujrat freatike me rritjen e lartësisë nga niveli detit.

Sipas klasifikimit pedologjik në këto zone ndodhen këto tipe tokash:

a. **Tokat Livadhore Malore:** Shtrihen në lartësi nga 1200 m mbi nivelin e detit deri në

majat me të larta, në të gjithë zonën malore të të gjitha fshatrave. Formohen në kushtet e klimës së lagët e me verë të thatë, në bimesi barishtore subalpine të rrallë. Kanë pak humus, janë skeletike e përmbajnë gur. Në përgjithësi janë toka subargjilore në të mesme e të lehta, mesatarisht të pasura me azot, fosfor e potas. Këto toka mbulohen me kullota alpine (për dhen) janë të cekta e mbi shkëmbinj gelqeror, vetëm sipër në sheshet e maleve rritet thellessia e tyre.

b. **Tokat e Murrme Pyjore:** Shtrihen në lartësi 900 – 1200 m, zone ku gjenden haloret

dhe një pjesë fletorësh, me trashësi horizonti 30 – 40 cm të thellë, mbi shkëmbinj amnor gelqeror.

c. **Tokat e Kafejta:** Shtrihen në lartësi 400 – 900 m mbi nivelin e detit që është zona e dushqeve. Trashësia e horizontit është me e madhe 50 – 80 cm. Shkëmbinjt amnor janë gelqeror, flyshor dhe shtufor. Ujrat freatik afrohen me shumë, nën 1m thellesi.

d. **Tokat e Hinjta Kafje:** Shtrihen në zonën kodrinore në lartësi 400 – 500 m mbi nivelin e detit.

Këto takohen në të gjithë zonën dhe zënë një përqindje të konsiderueshme edhe të sipërfaqes së tokës nën kulturë. Formohen në ndikimin e klimës mesdhetare kodrinore në bimesinë e shkurreve mesdhetare. Trashësia e profilin në këto toka, me përjashtime të rralla, shkon nga 1 – 1.22 m. Nga përberja mekanike janë subargjilore të mesme dhe rrallë të renda. Këto toka janë të

varfra dhe te mesme ne humus, fosfor, azot dhe te pasura ne potas. Perdorimi i plehrave organike dhe minerale krijojne kushte qe kulturat bujqesore te japin prodhime te larta.

e. Tokat Livadhore Aluvionale: Shtrihen ne te dyja anet e lumit te Vlores, me thellesi te profilit pedologjik mbi 80 cm, e me ujra freatike te cekta.

Veme ne dukje se zona e Tokave te Kafenjta, eshte me e gjera dhe tipike per zhvillimin e pyjeve fletor, vecanerisht dushqeve. Ne teresi niveli i humusit eshte i ulet, duke i klasifikuar kryesisht ne toka te varfera e pake ne mesatarisht te pasura. Sipas sistemit 100 pikesh (ball) te klasifikimit futen ne kategorin nga e 6 - 10 ose nga 10 - 50 ball, kjo per shkak te rreshjeve te shumta efekti i te cilave rritet mjaft si rezultat I demtimit te pyjeve me prerje e djegje duke sjelle edhe rritjen e erozionit, shpelarjen e tokes dhe ne disa vende edhe daljen ne siperfaqe te shkembit amnor.

4.5. RRJETI HIDROLOGJIK DHE BURIMET E FURNIZIMIT ME UJE

Ne pergjithesi eshte zone e pasur me ujera rrjedhese dhe burime të shumta, sidomos në krahun e djathtë, shkaku i te cilave jane malet e larta, karakteri i thyer malor ne pjesen me te madhe te saj, rreshjet e shumta qe bien, si dhe shkrirja e bores ne stinen e pranveres e te veres. Per kete arsye ky rajon pershkohet nga lumenj e perrenj me degezime te shumta dhe nga burime nentokesore. Karakteri i tyre malor ben qe ujërat te kene karakter torencial qe u jep atyre nje fuqi gerryese e transportuese te madhe te materialeve te ngurta.

Rrjeti i gjere hidrografik, ne menyre te vecante me lumin e Vloresme afluentet e tyre (degë) kryesorë, si dhe burimet e shumta ujore kane nje rendesi te vecante per zhvillimin e ketyre zonave malore. Ne rradhe te pare ndikojnë ne ndryshimin e klimes, ne formimin e tokave bujqesore ne te dy anet e rrjedhes se tyre, ne sigurimin e ujit te nevojshem gjate gjithe vitit per nevojat e bujqesise, blegtorise, etj.

Per shkak te terrenit shume te thyer dhe shperndarjes se rreshjeve, raporti i prurjeve mesatare te ujërave ne lum, ulen shume ne muajt gusht-shtator, ne masen 2 - 2.7 % te sasise vjetore, kurse ne deget e saj sekondare, prurjet gjate gusht- shtatorit jane 1.3 - 2 % te sasise vjetore. Prurjet e ujërave ne lumin e Vlorës ndryshojne shume sipas rreshjeve vjetore. Keshtu, ne ditet e lagëta, prurjet jane 3.15 here me te medha sesa ne vitet e thata.

4.6. EROZIONI NE SHPATE DHE RRJEDHIET UJORE

Ky fenomen ka nje perhapje te gjere ne gjithe teritorin e këtyre ekonomive. Ky fakt shpjegohet me raportet e disekuilibruara midis tipeve vegjetacionale e destinacioneve te perdorimit te teritoreve. Aktualisht 50 % e siperfaqes totale te kesaj zone eshte siperfaqe me destinacion jo pyjore (dmth pjesa tjeter eshte e cveshur, shkemb, gremine, kullote e toka bujqesore) ne te cilen fenomeni i gerryerjes eshte prezent qe nga ato siperfaqesore deri ne format nga me te aktivizuara. Ne shumicen e rasteve prane ketyre siperfaqeve gjenden vatrat me te medha te gerryerjeve ku

dhe perspektivat e rimekembjes tyre jane te pakta. Ne raste me te kufizuara verehen edhe rreshqitje, per te cilat duhen marre masa fitomeliorative per stabilizimin e tyre ne te ardhmen. Per parandalimin e ketij fenomeni pikerisht ne origjinen e tyre edhe nga popullsia lokale me emergjence jane propozuar te kryhen punime fitomeliorative te kombinuara me ato hidroteknike, si edhe me venien nen mbrojte te territorit dhe te bimesise pyjore.

Nje kujdes te vecante ne studim i eshte kushtuar mbrojties se qendrave te banuara dhe rrjetit rrugor nga prurjet e ngurta te shumta qe sjellin perrenjte malor. Po keshtu duhen marre masa per mbrojtien e burimeve ujore nga masat e ngurta duke i devijuar e pastruar daljet e burimeve.

4.7. RRËSHQITJET

Ky fenomen është present në shtratin e lumit Vlorës.

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

5.1. BREZAT BIOKLIMATIKE

Brezat bioklimatike prezente ne ekonomine pyjore dhe siperfaqen e tyre duke perdorur te nejtin klasifikim me ate te IKP 2018. Ky klasifikim te kryhet sipas mënyrës së mëposhtme:

- Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare kserofile dhe perhere te gjelber
- Vegetacioni i pyjeve dhe shkurreve azonale

5.2. PYJET DHE KULLOTAT

Kjo tabelle mund te merret direkt nga SISIP kur te jete funksional. E dhena jepet vetem per ngastren ne studim.

Ekonomia	Sip. totale Ha	Pyje (ha)	Pyje	Shkurre	Shkurre	Kullota	Kullota	Te tjera	Te tjera
			(%)	(ha)	(%)	(ha)	(%)	(ha)	(%)
Mali i Pilurit-Cilke	51.55	29.6		29.3		16		6.25	

5.3. TIPET E PYJEVE

Pre ngastrat ne studim kemi te bejme me pyje me Prrall (*Quercus crocifera*) dhe mare (*Arbutus unedo*).

5.4. TIPET E KULLOTAVE

Nuk ka rendesi ne kete studim

5.5. TIPET POTENCIALE TE VEGJETACIONIT

Ngastra e marre ne studim ka Prrall, mare, shqope etj.

5.6 BIODIVERSITETI

Ne zone ka kryesisht dy tipe vegetacionale Makie dhe te Dushkut
Flora

A. Druret

1. Dushqet

Quercus ssp. (Qarr, Bunge, Shparth)

- | | |
|-----------------------|----------------------------------|
| 5. Rrapi | <i>Platanus orientalis</i> |
| 7. Melleza | <i>Ostrya carpinifolia</i> |
| 11. Panja | <i>Acer pseudoplatanus</i> |
| 12. Frasheri i Bardhe | <i>Fraxinus Ornus</i> (i rralle) |

B. Shkurret

- | | |
|---------------------------|------------------------------|
| 1. Perralli | <i>Quercus coccifera</i> |
| 2. Mare | <i>Arbutus Unedo</i> |
| 5. Krifsha (Mbrete) | <i>Filloreia media</i> |
| 5. Shkoza | <i>Carpinus orientalis</i> |
| 6. Shqope | <i>Erica arborea</i> |
| 7. Grathate (mengjerisht) | <i>Erica herbacea</i> |
| 9. Qelbesi | <i>Pistacia terebinthus</i> |
| 10. Dellinj e kuqe | <i>Juniperus oxycedrus</i> |
| 11. Murrizi njeberthamsh | <i>Crataegus monogyna</i> |
| 12. Trendafil i eger | <i>Rosa canina.</i> |
| 13. Driza | <i>Paliurus Spinachristi</i> |
| 14. Shtogu | <i>Sambucus nigra</i> |
| 16. Thanat | <i>Cornus ssp.</i> |
| 17. Dellenja | <i>Juniperus sp.</i> |

C. Dru – Frutoret e Bute.

Perc druveve, shkurreve dhe shkurrezave pjore ne territorin me toka bujqesore takohen lloje dru – frutore te bute, si: bajamja, arra, dardhat, kumbullat, qershi dhe lloje te ndryshme rrushi ne forme pjergulle e vreshti (hardhi),

5.7. PRANIA E VLERAVE KONSERVUESE TE LARTA (VKL)

Nuk eshte e rendesishme per kete planmbareshtimi pjesor.

5.8. RREZIQET PER BIODIVERSITETIN DHE EFEKTET MBI PLANIFIKIMIN

Nuk ka.

5.9. MUNDESITE PER AKTIVITETET DIDAKTIKE DHE KERKIM SHKENCOR

ngastra eshte e mbrishme me rruge auto. Nuk frekuntohet.

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

6.1. ANALIZA E TË DHENAVE PËR PYJET

6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve

Ngastra është me shkurre. Tedhena idebtifikuese:

Ngastra nr	Gërma	Elnomia pyjore/Kullosore	Sipërfaqja në Ha
69a	a	Mali i Pilurit-Clke	29.3

6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes

Paraqisni të dhënat në formë tabelare të cilat merren nga programi MS Access i rikonfiguruar ose nga SISP.

Trungishtë

Parcela nr	Kodi nën parces	Tipi i Pyllit	Sip (ha)
------------	-----------------	---------------	----------

Cungishtë

Parcela nr	Kodi nën parces	Tipi i Pyllit	Sip (ha)
------------	-----------------	---------------	----------

Pyje të perziere

Parcela nr	Kodi i nën/ parces	Tipi i Pyllit	Sip (ha)	Klasa e moshes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)
------------	--------------------	---------------	----------	----------------	-----------------------------	------------------------------

Shkurre

Parcela nr	Kodi i nënparces	Tipi shkurreve	Sip (ha)	Klasa e	Volumi	Vol. total
				moshes	(m ³ /ha)	(m ³)
69a	a	Mare,Prrall,Mbrete,Shqope	29.3	3	4	117

6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit

Ngastra është me shkurre t. Faza e zhvillimit është rinisë dhe pleqerisë.

6.2. ANALIZA E TË DHËNAVE TË KULLOTAVE.6.2.1. Gjëndja e kullotave

Gjëndja e kullotës është mesatare.

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

7.1 REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE

7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit

Me qëllim vlerësimin e saktësisë së inventarizimit është e nevojshme të analizohen parametrat statistike kryesore:

- Vlerësimi u bë me sipërfaqe prove dhe me sy (per kuroredendësine)

Perlogaritjet e volumeve per ha dhe ngaster u bë me Excel form

Te dhënat per skeden u morën edhe nga nga programi MS Access.

7.1.2. Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore

Ne ngastrat 95, me shkurre, grumbulli e shtë l ri, në ngastrat 117,118,119, me shkurre, grumbulli ka arritur moshen e pleqerise dhe rritja eshte drejt zeros.

7.1.3. Struktura Vertikale

Pyje me shkurre, 1 kat, me origjine llastaror.

7.1.5. Cilësia e materialit drusor

Materiali drusor eshte vetem dru zjarri.

7.2. GJËNDJA SHËNDËTSORE DHE FITOSANITARE

7.2.1. Drurët e tharë

Kjo siperfaqe eshte e pershkruar nga zjarri ne vite, dhe ka demtime (drure te thate), ne forem njollash.

7.2.2. Dëmtimet e tjera

Nuk ka.

7.3. PRERJET E PALIGJSHME

7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit

Ka prerje te paligjshme ne vite.

7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale ne planifikimin dhe mbareshtimin e pyjeve

Nuk ka.

7.4 REZULTATET E INVENTARIZIMIT TE KULLOTAVE

7.4.1. Tipi dhe cilesia e kullotave.

Nuk ka

7.4.2. Perdoruesit e kullotave dhe koha

Perdoruesit familjare, jane fermer te zones. Ata l perdorin nje pjese per dimer, nje pjese per vere.

7.4.3. Llojet e bagetive

Jepen ne tabelat me poshte .

7.4.4. Perdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtes i kullotave

Nuk ka

7.4.5. Infrastruktura aktuale

Jepet ne pershkrimin prcelar te cdo ngastre.

7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorise me baze ushqimore.

Problem eshte stina e dimrit .

8. OBJEKTIVAT E MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR PLANIFIKIMIN AFAT-GJATË

Plani i Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave identifikon objektivat afat-gjate te mbareshtimit, jo vetem ne periudhen e vlefshmerise se tij, por edhe ne dekadat ne vijim. Keto objektiva duhet te jene te pergjithshme, por njekohesisht edhe te mundshme per tu realizuar si: (i) shtimi i siperfaqes pyjore dhe volumit ne kembe nepermjet prerjeve rigjeneruese; (iii) reduktimi i siperfaqeve te degraduara; (v) mirembajtien dhe rritjen e vitalitetit dhe gjendjes shëndetsore të ekosistemeve pyjore dhe kullosore; (vii) përmirsimin e funksioneve prodhuese etj. Menaxhimi shumefunksional duhet te nxitet në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete si dhe të rritet gama e të mirave dhe produkteve që sigurohen per shoqerinë.

8.2. OBJEKTIVAT KOMBETARE PER ZHVILLIMIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Në planin e mbareshtimit, i referohemi programit te qeverise per zhvillimin e sektorit pyjor dhe kullosor, strategjise per zhvillimin afatshkurter dhe afatgjate te pyjeve dhe kullotave si dhe programeve qeveritare per pyllzimin dhe reduktimin e gazeve 15ete .

8.3. PAJTUESHMERIA E PMPK ME PLANIFIKIMIN RAJONAL DHE ATË NË NIVEL BASHKIE

Pyjet dhe kullotat janë pjesë integrale e territorit të seciles bashki dhe për këtë arsye duhet të përfshihen në "Strategjinë e Zhvillimit të Territorit" dhe në "Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë" i cili njihet me emrin "Plani i përgjithshëm i zhvillimit të Bashkisë" (plane të zhvillimit të bashkive etj). Pyjet dhe kullotat janë elemente që përshkruhen në kapitullin e dytë të këtyre planeve, në seksionin 2 me titull: "Karakteristikat mjedisore të bashkisë". Plani ka të bëjë me disa aspekte që janë ngushtesisht të lidhura me pyjet dhe kullotat.

Disa nga problemet me të rëndësishme që trajtohen në këtë plan janë: *pronesia e pyjeve dhe kullotave; përdorimi i territorit; ndarja e territorit në sisteme urbane, natyrore, bujqesore dhe ujore.*

Në një kapitull të veçantë me titull "Drejtimet për zhvillimin e territorit të Bashkisë bazuar në treguesit e sistemeve" duhet të jepet strategjia dhe vizioni për zhvillimin e sistemit natyror duke përfshirë këtu pyjet dhe kullotat. Prandaj informacioni që sigurohet nga planet e mbarështrimit të hartuar për secilën njësi menaxhimi 16eter16 territorit të bashkisë duhet të integrohen në këtë plan zhvillimi duke nënkuptuar se këto plane duhet të jenë në pajtueshmeri edhe me Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë.

8.4. OBJEKTIVAT KRYESORE TË PMPK

Nepermjet këtij plani do të sigurohet dru zjarri për ngrohje për shkollat dhe institucionet të territorit të Bashkisë. Gjithashtu, nepermjet mbrojtjes nga kullotja, do të sigurohet ripërteritje e pyllit.

8.5. OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË EKONOMISË PYJORE/NJM

Bazuar në objektivat kryesore përcaktoni objektivat specifike të planit të mbarështrimit bazuar në gjëndjen aktuale dhe përshkruani procesin e përcaktimit të këtyre objektiveve.

8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështrimit

Funksionet specifike të pyllit do të jenë prodhim dru zjarri për ngrohje.

8.5.2. Objektivat specifike mbi 16eter16 e pyjeve

Grumbullimi i pyjeve (me shkurre të llojit Mbretë dhe Prall), ka arritur moshën e pleqërisë duhet të pritet rrah një pjesë e sipërfaqes duke mundësuar dhe siguruar rigjenerimin (ripërteritjen) e shkurreve.

8.5.3. Objektivat 16eter16e16 silvikulturale

nderhyrje me prerje shendetesimi (rrah) në shkurre pjesërisht të sipërfaqes së ngastres dhe garantimi ripërtëritjes.

8.5.4. Objektivat 16eter16e16 mbi faunen

Të respektohet ligji dhe moratorium, etj.

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1. PRERJA VJETORE E LEJUAR/MUNDËSIA VJETORE E SHFRYTËZIMIT

Rregullimi i prodhimit, pavarësisht sistemit silvikulturor të përdorur, siguron një bazë të 16ete për një shfrytëzueshmëri afatgjatë në 16eter16e me rritjen e grumbujve pyjorë. Kjo kërkon një kontroll për tu siguruar që prerja vjetore/mundësia vjetore e shfrytëzimit nuk është as më e madhe dhe as më e vogël se rritja vjetore. Metodat e përdorura për llogaritjen e mundësisë vjetore të shfrytëzimit jepen në aneksin e udhëzuesit.

9.2. PRERJA VJETORE SILVIKULTURORE

Prerja vjetore silvikulturore përfshin sasinë e volumit të materialit drusor, që nxirret nga masat ose trajtimet silvikulturore në 1 vit si: prerjet shendetesimi/prerjet rrah. Ky volum shprehet në meter kub për 1 ha ose në 16eter kub.

9.3. PLANIFIKIMI VJETOR I MASAVE

9.3.1. Masat në Pyje

Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve – Pyjet

Ngastrat në studim janë me shkurre

9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre

Sipërfaqen me shkurre që do të preket nga trajtimet silvikulturore të mëposhtme:

-Nuk ka

9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi

Në sipërfaqet djerr dhe bosh

9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore dhe kullimore.
nuk ka

10. VLERËSIMI EKONOMIK

10.1. VLERËSIMI I EFEKTEVE TË MASAVE TË PLANIFIKUARA NË PYJE dhe KULLOTA

Efektet e masave të planifikuara në pyje ndikimin në: (i) cilësinë/sasinë e grumbujve pyjorë (cilësinë/sasinë e produkteve drusore dhe jodrusore. Në kullota janë planifikuar masa në përparim të kullotës dhe infrastrukturës.


Viti	Ekonomia Pyjore/Kullimore	Kodit në parcelës	Sip (ha)	Procesi i ndërllojës	Njesia	Sasia	Volumi materialit që sigurohet (m ³)	Shënim
2024	E.P.Mali I Pijurit_Cike	69a,b,c	51.55	Agropylltari, agroturizem	ha	2		
2025	E.P.Mali I Pijurit_Cike	69a,b,c	51.55	Agropylltari, agroturizem	ha	2		
2026								
2027								
2028								
2029								
2030								
2031								
2032								

10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

Do të sigurohet kullota me afat 10-vjeçar për fermerët e zonës si dhe do të garantohet ripërteritja dhe arritja e grumbullit të ri.

10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve

Kosto llogaritet punimet që do të kryhen për mirmbajtjen e kullotave dhe pyjeve. Përfitimi është sigurimi i të ardhurave nëpërmjet kontratave afatgjatë për kullotjen e blektorise nga fermerët e zonës, i ripërteritjes së grumbullit pyjor dhe përmirësimi i peisazhit.



PERSHKRIMI PARCELAR

Klhim

Print

35 069a

A. TE DHENA IDENTIFIKUESE

Ekonomia Pyjore : Mali I Pilurit-Cike
 Komuna, Rrethi : Himarë Vlorë
 Pj.ekon : 0

Ngastra nr.ekz 69 Emri ng/nng Lejebardhat
 nr.ri: 69 ekzist: a
 N/ngastra e re: a

Sektor i pyjor nr. : Perd. teritorit: Pyll
 Pronesia : Bashkia
 Siperfaqja(ha): 29.3

B. GJENDJA AKTUALE

1. Pershkrimi i teritorit

Forma e relievit : Shpat
 Kundrejtimi : Veri

Lart.zot : 290 (234 - 350)m
 Pjerrresia : 11 - 40%
 Orteqet : Mungojne
 Shk.annor : Gelqeror

Hidrografia numri Regjimi ujq
 Perrua 1 Shtershem

2. Tota

Tipi : murr.pyjore
 Thellesia : <15cm

Lageshtia Thale
 pH : Bazik
 Trash. legush : 1 - 2cm
 Trash.humusi 1 - 2cm

Struktura : Me strukture
 Textura : A
 Gure ne sip.% 5
 Men.shpernd. : Shpemdare

3. Erozioni

Siperfaq. ha : 0.586 origjina Hidrik
 Ne thell. ha : 0.879 ecuria : Qendruesh
 Rreshq. shem: 0

4. Forma e qeverimit, Funksioni

Forma e qeverimit : Shkurre
 Funksioni kryesor : Prodhues

Funks. Pr.te dyta-Bar
 vec. : Argelim,turizem

Bime Dellinja e kuqe
 mjek : Hithra

Funksione rekreative
 frekuentimi Ulet
 ecuria : Rritje
 periudha : Gjithe viti

5. Karakteristikat silvikulturore te grumbullit

Struk.verifikate : Nje kat
 Homogeniteti :
 Intens.nderhyr : Mesatar

Perd.pr.stac. : Mesatar
 Cilesia e grumb. Ulet
 Perkuqjesja : Mesatar
 Origjlna : natyral me llastare

Dr. te thare :
 % : 5 ha: 1.465
 shk. kryes Te panjohura
 shk. dytes

Dr. te demtuar :
 % : 5 ha: 1.465
 shk. kryes Te panjohura
 shk. dytes

Renje gjethi : shk. kryes Nuk ka <6%
 vell tot.: 2

Prerje te paligi : % sip.: 1 nr.dr.: 120

Ripertertija natyrore :
 nga: deri: mesatar: nr/m2: perdor. %:

Nen pylli

Kl e mosh zot :

11-15vje

Tipi i grumbullit : Pyje me prall

6. Karakteristikat dendrometrike per 1 ha

kati%	kati	lloji%	Lloji	perz.	Kd	Td	Nr.dr	H _z	M	Dm	G	K.Pr.	V Tot	L.Tr	L.Mes	L.Holl	D.Zj	Lev	Rr.vij	Rr.mes.	RMVA
	1	25	Prr		0.1	0.00		2	15	2.0			1.0	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.2	0.2	0.1
0	1	25	Mbr		0.1	0.00		2	15	3.0			1.0	0.0	0.0	0.0	1.0	0.0	0.2	0.2	0.1
0		50	Mar		0	0.00							2.0	0.0	0.0	0.0	2.0	0.0	0.4	0.4	
0		0	shq		0.1	0.00		2	15	3.0			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			0.0
0		0	Shq		0.1	0.00		1		1.0			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0			
0					0.4	0.00							4.0	0.0	0.0	0.0	4.0	0.0	0.8	0.8	

Historiku u grumbullit

ng.	n/ng.	vol./ha	perdorimi teritorit	forma e qeverimit	tipi grumbullit	lloji (%/lloji)
69 a	1		Pyll	Shkurre	Pyje me makie	30 Mareja lloje
0	0					30 Pralli
0	0					20 Shqopa lloje
0	0					20 Pralli

7. Biodiversiteti

Tipi i vegetacion :
 potencial : Pyje me prall
 Shkalla e natyralitetit : Natyral
 Biotope : Siperfaqe terreni qe kane nderruar destinacion (nje os

Shenime:

Jane shkurre te degraduara nga kullotja dhe prerjet ne vite. Volumi drusor mesatar i shkurreve eshte 4m3 per ha, dru zjarrl. Llojet e jane prall, mbrete, mare, shqope. Brenda nengastres ka siperfaqe boshe (lëndina) rreth 2 ha, ne pjesen verilindore (afër perroit) (Pasurite 383,385.Z.K.3823.

VL35 69a

E. MONITORIMI I NDERHYRJEVE

Nderhyrjet e parashikuara	Urgjenca	ha	m3	viti	ha	m3	nderhyrje e realizuar
Agropylltari	1	2		2024			
Agroturizem(Kamping)	1	1		2024			
Agropylltari	1	1		2025			
				2026			
				2027			
				2028			
				2029			
				2030			
				2031			
				2032			
				2033			